



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Gusht 2021/ Nr. 8



AFA sipas modelit të West Point
76 oficerë përfunduan
dy kurset e gradave
KLO dhe KKSHP



Shqipëria e drejtoi SEDM-in nga '19-'21
Shqipëria i dorëzon
Bullgarisë kryesimin e
iniciativës rajonale SEDM



Gjeneralmajor Begaj-kolonel Kablay
Bashkëpunimi ynë me
Turqinë në fushën
ushtarake do të vazhdojë



AGJENCIA E SISTEMEVE TË NDËRLIDHJES DHE INFORMACIONIT (ASNI)

Peleshi: Mbrojtja kibernetike është element
kyç përballë kërcënimeve nga fuqi rivale

Përmbajtja

Numri 8

FORCAT SPECIALE

- 7** Stërvitje e përbashkët e ushtarëve amerikanë dhe shqiptarë

BASHKËPUNIMI

- 12** Kontingjenti VIII i EOD, pjesë e misionit të Prezencës së Përparuar "eFP" në Letoni, kthehet në Atdhe

GJENERALMAJOR BEGAJ-KABLAY

- 15** Bashkëpunimi ynë me Turqinë në fushën ushtarake do të vazhdojë

POLICIMI AJROR

- 42** NATO shënon 60 vjetorin e patrullimeve ajrore evropiane

72-VJETORI I PROVKACIONEVE TË GUSHTIT

- 36** Lufta Civile dhe Provokacionet e 2 Gushtit 1949 në shtypin shqiptar

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:

Suela HODA



4 ASNI

Peleshi: Mbrojtja kibernetike është element kyç përballë kërcënimeve nga fuqi rivale

Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI), pjesë e rëndësishme e Forcave të Armatosura të Shqipërisë kremtoi, më 30 qershor 2021, 90-Vjetorin e Krijimit të...



6 AFA SIPAS MODELIT TË WEST POINT

76 oficerë përfunduan dy kurset e gradave KLO dhe KKSHP

Shtatëdhjetë e gjashtë oficerë të Forcave të Armatosura dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës përfunduan kurset e gradave KLO dhe KKSHP në...



11 SHQIPËRIA DREJTOI NGA '19-'21

Shqipëria i dorëzon Bullgarisë kryesimin e iniciativës rajonale SEDM

Mbi bazën e rotacionit, që nga 1 korriku 2021, Ministria e Mbrojtjes e Bullgarisë është kryetare e Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore (SEDM Process). Shqipëria...



17 INTERVISTA

Kolonel Ahmet Leka: Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, si një strukturë e re Akademike, produktet dhe vizioni

"Doktrina Ushtarake hartohet dhe zhvillohet duke u bazuar në Strategjinë e Sigurimit Kombëtar dhe Strategjinë Ushtarake të RSH. Ajo...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 8/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elek-
tronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





AGJENCIA E SISTEMEVE TË NDËRLIDHJES DHE INFORMACIONIT (ASNI)

Peleshi: Mbrojtja kibernetike është element kyç përballë kërcënimeve nga fuqi rivale

Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI), pjesë e rëndësishme e Forcave të Armatosura të Shqipërisë kremtoi, më 30 qershor 2021, 90-Vjetorin e Krijimit të Shërbimit të Ndërlidhjes. Pjesë e

ceremonisë së organizuar me këtë rast ishin edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Përgjithshëm i Shtabit të FA gjeneralmajor Bajram Begaj, zëvendësministri Dallëndyshe Bici si dhe ish-ushtarake, ish-punonjës të ASNI.

Në fjalën përshëndetëse, ministri

i Mbrojtjes Niko Peleshi vuri në dukje se kjo agjenci është një arterie dhe komponent shumë i rëndësishëm dhe i pa zëvendësueshëm i gjithë përpjekjes që FA bëjnë për të mbajtur me nder edhe me dinjitet pozicionin që u takon si pjesë e NATO. Duke vlerësuar punën dhe arritjet e kësaj



Mbrojtja kibernetike është pjesë e sigurisë kombëtare. Në bashkëpunim me aleatët amerikanë po ngrihet Njësia e Mbrojtjes Kibernetike



struktura në 90 vite të funksionimit të saj, ministri i Mbrojtjes foli për sfidat që e presin në të ardhmen.

"Sot platformat e komunikimit janë rritur shumë, trafiku i komunikimit dhe i ndërlidhjes është shtuar së tepërmi, çka do të thotë se edhe ekspozimi ndaj kërcënimeve është

rritur shumë. Mbrojtja kibernetike, natyrisht sot është pjesë e sigurisë kombëtare dhe është kthyer në një fjalë kyçe në të gjitha, diskutimet, komunikimet, platformat, politikat e NATO-s dhe aleatëve tanë. Rajoni ynë dhe bashkë me të edhe Shqipëria natyrisht nuk bën dallim, jemi pjesë

e globit, por natyrisht jetojmë edhe në një rajon, i cili ka pranë kërcënime edhe nga fuqi rivale, të cilat veç të tjerash dhe më së shumti përdorin komunikimin e ndërlidhjen, botën kibernetike si një armë për të penetruar dhe për të rritur influencën e tyre", - theksoi ministri Peleshi.

Z. Peleshi theksoi faktin se tashmë teknologjia, inovacioni, ndërlidhja, komunikimi, teknologjitë e informacionit janë kthyer në një prioritet të Ministrisë së Mbrojtjes. Për t'iu përgjigjur sfidave të kohës, z. Peleshi tha se në bashkëpunim me aleatët amerikanë po ngrihet Njësia e Mbrojtjes Kibernetike. Duke premtuar edhe përmirësim të sistemit të motivimit që nga pagat, shpërblimet apo edhe kualifikimet ai u shpreh: "Ju keni bërë një punë të shkëlqyer ndër vite dhe tani keni strukturë të re, e cila do t'i shërbejë organizimit të punës dhe rritjes së efikasitetit të performancës suaj, por nga ana tjetër ne do të bëjmë më të mirën edhe për sistemet e tjera të motivimit, nga pagat-shpërblimet edhe deri te hapësirat e kualifikimit, e rikualifikimit, hapësirat e riprodhimit të sa më shumë kapaciteteve njerëzore, të cilat mund të jenë në dispozicionin tuaj. E kam fjalën kryesisht për Akademinë e Forcave të Armatosura, ku këtë vit të ri akademik ne do të hapin dy-tre programe të reja, dy programe në 'bachelor', një prej tyre është Teknologji Informacioni në fushën e Mbrojtjes, tjetra është Komandim Detar në fushën e Mbrojtjes, si dhe një 'master' në Siguri Kibernetike".

Zanafilla e krijimit të kësaj agjencie daton më 30 qershor 1931 me krijimin e dy kompanive të ndërlidhjes dhe një kompani telegrafiste. Pas gjithë këtyre viteve shërbim ndërlidhje, sot ASNI është në gjendje të sigurojë dhe të mbështesë me sisteme komunikimi dhe informacioni për realizimin e komandim-kontrollit të FA në nivel strategjik dhe operacional në të gjitha kohërat si dhe të shkëmbejë informacion me NATO-n, të trajnojë dhe të stërvisë personelin e shërbimit të ndërlidhjes në FA.

Së shpejti mësimi në anglisht, AFA sipas modelit të West Point

76 oficerë përfunduan dy kurset e gradave KLO dhe KKSHP

Peleshi: “Së shpejti do të kemi një vizitë në West Point besoj edhe vet kryeministri do të jetë me ne aty për të jetësuar modelimin e Akademisë FA sipas modelit të West Point”

Shtatëdhjetë e gjashtë oficerë të Forcave të Armatosura dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës përfunduan kurset e gradave KLO dhe KKSHP në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA). Ushtarakët shqiptarë ndoqën për rreth një vit Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) dhe Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP). Në ceremoninë e diplomimit oraganizuar të enjten që kaloi, datë 15 korrik 2021, ishte i pranishëm ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Bajram Begaj, zëvendësshefja e SHP gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i AFA gjeneral brigade Albert Mullai, komandantë forcash etj.

Ministri Peleshi ndau me të pranishmit përshtypjet e mira që kishte lënë përgatitja, profesionalizmi dhe niveli i ushtarakëve shqiptarë gjatë stërvitjes “Defender Europe 21”. Më tej zoti Peleshi shpalosi planet për rritjen e mëtejshme të nivelit të arsimimit të ushtarakëve shqiptarë, duke marrë shembull një ndër akademitë ushtarake më prestigjioze të botës, West Point në SHBA.

“Dua të ndaj me ju ambicien tonë për t’i dhënë një dimension shumë të fortë Akademisë së FA në bashkëpunim me aleatët tanë në NATO e veçanërisht me partnerin tonë strategjik SHBA, me të cilët

jo vetëm unë personalisht, por edhe vetë kryeministri në të gjitha takimet që ka patur me nivelet më të larta të NATO-s, por edhe Departamentit të Shtetit ka ngritur si kërkesë dhe si ftesë për bashkëpunim ristrukturimin dhe fuqizimin e Akademisë së FA. Ajo çka ju intereson drejt për së drejti janë 4 kurset e nivelit të lartë të cilat duam t’i ngremë gjithashtu në një nivel tjetër. Kemi formuluar ambicie që brenda 3 vitesh të hapen këto kurse dhe do duhen të jenë në

anglisht. Duam t’i paketojmë kurset në një Kolegj të Mbrojtjes duam t’i japim përmasë rajonale. Duam t’i shërbejmë edhe vëllezërve tanë në Kosovë, por pse jo edhe në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, apo dhe më gjerë se kaq. Së shpejti do të kemi një vizitë në West Point besoj edhe vet kryeministri do të jetë me ne aty për të jetësuar modelimin e Akademisë FA sipas modelit të West Point.” - deklaroi ministri Peleshi. Kursin e Lartë të Oficerit e ndoqën 19 ushtarakë, ndërsa në



Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm u diplomuan 57 të tillë. Veç njohurive shtesë në shkencat ushtarake, KLO dhe KKSHP u shërbejnë ushtarakëve për marrjen e gradave nënkolonel dhe kolonel.



Forcat Speciale të Shqipërisë dhe Amerikës në Zall-Herr

Stërvitje e përbashkët e ushtarëve amerikanë dhe shqiptarë

Forcat Speciale të Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës u trajnuan dhe stërvitën së bashku për rreth 3 javë në Zall-Herr, ku punuan mbi teknika të ndryshme në fushën e luftimit, duke simuluar situata reale. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, vizitoi nga afër, më 31 korrik 2021, stërvitjen e forcave speciale të dy vendeve, ndërsa u shpreh i impresionuar nga aftësitë e treguara nga Forcat Speciale gjatë stërvitjes me kolegët e tyre amerikanë. Peleshi tha se “mbi të gjitha u ndjeva jashtëzakonisht krenar për vlerësimet maksimale që dëgjova nga



përfaqësues të Forcave Speciale të SHBA për trupat tanë”. “Dhënia e ndihmës së shpejtë, rivendosja e komunikimit duke memorizuar frekuencat, transportimi i municioneve, qitjet nga pozicione të ndryshme, të gjitha në mënyrë të njëpasnjëshme, ishin sa sfiduese, aq edhe mbresëlënëse”, tha Peleshi. Pas stërvitjes së suksesshme ushtarake “Defender Europe 21”, e cila përfundoi në Shqipëri muajin e kaluar, ushtarët amerikanë u stërvitën së bashku me forcat tona në trajnimin e përbashkët njëmuor të kombinuar të shkëmbimit në bazën e Forcave Speciale shqiptare në Zall-Herr.

Peleshi: Diploma ekuivalente me akademitë e vendeve të NATO-s

“Të gjithë ushtarakët tanë, në veçanti oficerët duhet të mbajnë në mendje që nuk janë vetëm ushtarakë të Republikës së Shqipërisë, por dhe ushtarakë të Aleancës së madhe Euroatlantike ku ne duhet të përfaqësohemi në mënyrën më profesionale dhe më dinjitoze, duhet të përfaqësojmë rolin dhe emrin e vendit tonë.

59 kadetë, mes të cilëve 13 vajza dhe 46 djem përfunduan me sukses Kursin e Përgatitjes së Oficerit të Ri, i cili zgjati

37 javë. Në ceremoninë e diplomimit dhe betimit të tyre, organizuar më 27 korrik 2021, morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Bajram Begaj, zëvendës shefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Manushaqe Shehu, deputetë, komandantë të forcave si dhe atashe ushtarakë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi se përfundimi me sukses i këtij kursi është kapërcim i madh, një inkurajim dhe motivim i merituar për këta të rinj, si oficerët më të rinj të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ministri Peleshi theksoi se objektivi i Ministrisë së Mbrojtjes mbetet që sistemit të

edukimit ushtarak t'i jepet një vizion i ri, duke e kthyer këtë sistem në laborator të përpunimit të mendimit teorik ushtarak, ndërsa fushat, poligonet dhe terrenet e stërvitjes, në praktika eksperimentale.

“Të gjithë ushtarakët tanë, në veçanti oficerët duhet të mbajnë në mendje që nuk janë vetëm ushtarakë të Republikës së Shqipërisë, por dhe ushtarakë të Aleancës së madhe Euroatlantike ku ne duhet të përfaqësohemi në mënyrën më profesionale dhe më dinjitoze, duhet të përfaqësojmë rolin dhe emrin e vendit tonë. Kjo do të thotë që karriera juaj do të jetë në vëmendje të vazhdueshme edhe për arsimimin, trajnimin dhe kualifikimin e mëtejshëm jo vetëm në shkollat tona ushtarake por dhe në shkollat e vendeve aleate dhe partnere”, - u shpreh gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi.

Ai ndau me të pranishmit edhe planin e punës, për të cilin po punohet me drejtues dhe stafin e Akademisë së FA për vitin e ardhshëm akademik. “Sfidat me të cilat përballemi janë gjithnjë e më të mëdha e gjithnjë e më të komplikuar ndaj ne duam që AFA duke filluar nga viti i ardhshëm akademik të formojë jo vetëm oficerë me formimin shkencor ushtarak, por dhe me specialitete të tjera, ndaj do të hapim dy programe këtë vit: “Teknologji Informacioni në fushën e Mbrojtjes” është njëri prej tyre, program bachelori si edhe “Navigacion dhe Komandim Detar”, është programi tjetër bachelorit. Dhe krahas këtyre programeve të bachelorit, që për herë të parë hapen pranë Akademisë së Forcave të Armatosura do të hapim edhe programin e masterit në Siguri Kibernetike”, shtoi ministri. Ministri i Mbrojtjes deklaroi se kjo ambicie do të shkojë më përpara duke e kthyer këtë akademi, sipas modelit “West Point”, e cila në një të ardhme të afërt apo afatmesme të mund të prodhojë oficerë të cilët dalin me një diplomë mundësisht ekuivalente sikur të kenë studiuar në “West Point”, apo në akademi të tjera më prestigjioze të SHBA dhe të vendeve të NATO.



Dymbëdhjetë nëntogerë të cilët po ndjekin Kursin e Pilotit Ushtarak në Bazën Ajrore të Farkës nisën praktikën fluturuese me helikopterët që shërbejnë për procesin mësimor. Kadetët nisën praktikën fluturuese pas përfundimit me sukses të fazës teorike.

Në fluturimin e parë të kadetëve ishte i pranishëm me 22 korrik 2021, edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili shoqërohej nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj.

Ministri Peleshi e konsideroi këtë ngjarje si shumë të rëndësishme dhe krahas rritjes së kapaciteteve njerëzore, vuri theksin edhe te rritja e kapaciteteve të mjeteve fluturuese: "Për ne është shumë e rëndësishme pasi pas 15 vitesh po prodhojmë vetë, me kapacitetet tona pilotët e rinj. Me kosto të larta, me kontributin dhe mbështetjen e vendeve të tjera partnere, ne kemi krijuar kapacitet tona të pilotëve, por tani po vëmë në dispozicion dhe në funksion kapacitetet tona njerëzore të brendshme për të nxjerrë 10-12 pilotët e parë. Krahas burimeve njerëzore, po punojmë për përmirësimin e infrastrukturës, për rritjen e gatishmërisë së helikopterëve. Duhet punë për të rritur numrin e helikopterëve në gatishmëri dhe të bëhemi gati për të operuar me helikopterët Black Hawk, që pas pak muajsh do të bëhen pjesë e flotës tonë këta helikopterë amerikanë, si pjesë e partneritetit me partnerin tonë special SHBA. E gjitha kjo është në kuadrin e një ambicieje shumë të madhe që kemi për t'iu rikthyer me shumë forca edukimit dhe këtu e kam fjalën për AFA, që është rihapur dhe që këtë vit do të ketë një përmasë të re që nuk e ka pasur më parë." - u shpreh zoti Peleshi, i cili përfitoi nga rasti t'i bëjë thirrje maturantëve shqiptarë të zgjedhin Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) për të ndjekur studimet e larta.

"Është padyshim një nga mundësitë më të mira në treg të studiosh pranë AFA, nuk kemi vetëm ofertën shumë të mirë të shkollimit të bachelorit në shkenca ushtarake,



Kursi i Pilotit Ushtarak në Bazën Ajrore të Farkës

Dymbëdhjetë nëntogerë, kursantë për pilotë nisin praktikën fluturuese

Faza e dytë e praktikës fluturuese për kadetët në kursin e pilotit është parashikuar të zgjasë rreth 6 muaj

por paralel me të do të hapim këtë vit për herë të parë edhe dy programe të tjera bachelor, një program në Shkencat e Teknologjisë së Informacionit plus formim ushtarak dhe një tjetër Navigacion - Komandim Detar dhe patjetër Shkenca Ushtarake. Përveç këtyre do të hapim edhe një program me 20 studentë në Cyber Security, master në Sigurinë Kibernetike. Këto janë oferta që mund t'i gjeshe në treg në universitete të tjera private apo publike, por ne edhe në kuptimin e përballimit material të kostove materiale të shkollës jemi padyshim oferta më e mirë në treg, sepse çdo student që do të aplikojë, konkurrojë dhe në fund

kualifikohet për një nga programet tona ka akomodimin falas, ka trajtimin ushqimor falas, edhe një pagë, ose kontribut prej 330 mijë lekësh të vjetra në muaj për çdo student. Ka shumë arsye pse unë me shumë sinqeritet i bëj ftesë të rinjve shqiptarë, maturantëve të sapodiplomuar të aplikojnë nga data 29 korrik deri në 3 gusht, përmes portalit si gjithë programet e tjera përmes programit u-Albania." Faza e dytë e praktikës fluturuese për kadetët në kursin e pilotit është parashikuar të zgjasë rreth 6 muaj, ndërkohë që nga ana tjetër, Akademia e FA po përgatitet për të mirëpritur brezin e dytë të studentëve.

Në Uzinën Mekanike në Gramsh janë demontuar 15.401 armë të vogla dhe të lehta të konfiskuara ose të grumbulluara përmes fushatave të vazhdueshme të sensibilizimit.

Ky proces pune u inspektua më 21 korrik 2021, nga zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, zëvendësministër i Brendshëm dhe kryetar i Komisionit Kombëtar të AVL (Armëve të Vogla dhe të Lehta) Besfort Lamallari, anëtarë të Komisionit Kombëtar të AVL nga institucione të ndryshme dhe agjenci të pavarura, përfaqësues nga ambasada.

Zëvendësministria e Mbrojtjes, Dallëndyshe Bici vlerësoi se shkatërrimi i armëve ilegale kontribuon në rritjen e sigurisë së vendit tonë: "Ne si Ministri e Mbrojtjes dhe Ministri e Brendshme, por edhe Komisioni Kombëtar për AVL-të përforcojmë mesazhin rreth rrezikut që armët e zjarrit të pakontrolluara paraqesin për sigurinë e individëve, sigurinë e shoqërisë dhe stabilitetin e rajonit" - u shpreh zëvendësministria Bici.

Ajo nënvizoi më tej faktin se bashkëpunimi shumë i mirë mes institucioneve tona në përmirësimin e legjislacionit, do të vazhdojë në të ardhmen në të gjithë komponentët e strategjisë, si në luftimin e trafikut të paligjshëm nëpërmjet rritjes së sigurisë kufitare detare, në shkatërrimin e armëve të tepërta, në përmirësimin e kushteve të sigurisë të depove të armatimeve dhe në sensibilizimin e popullatës për rreziqet e këtyre armëve.

Ndërkaq, zëvendësministri i Brendshëm Besfort Lamallari theksoi se informimi për procedurat e ndjekura shërben si një fushatë ndërgjegjësimi dhe transparence.

"Ky është një proces, i cili garanton sigurinë nga risqet e magazinimit apo ruajtjes së tepërcave të armatimit dhe municionit të dalë jashtë përdorimit apo atij të grumbulluar nga sekuestrimet dhe provat materiale, duke sjellë në vëmendje faktin se, armët e vogla dhe të lehta, municionet e tyre dhe eksplozivët,

Konfiskim-Grumbullim: Demontohen 15.401 armë të vogla e të lehta

Shqipëria është vendi i parë në rajon që shkatërroi i pari, armët e trashëguara nga sistemi i kaluar



nëse nuk kontrollohen, mund të paraqesin kërcënim për sigurinë e brendshme dhe më gjerë" - u shpreh Lamallari.

Aktiviteti u mbyll me një demon-

strim mbi shkatërrimin e armëve të vogla dhe të lehta të sekuestruara. Shqipëria është vendi i parë në rajon që shkatërroi i pari, armët e trashëguara nga sistemi i kaluar.

Mjetet e famshme ushtarake në botë përdoren edhe në FA

The High Mobility Multipurpose Wheeled Vehicle të njohura si Humvee, janë ndoshta mjetet më të famshme ushtarake në botë të cilat kanë hyrë në përdorim edhe në Forcat tona të Armatosura. Nga vetë emri, ato kanë një lëvizshmëri të lartë, janë padyshim të blinduara dhe kanë një shpejtësi maksimale prej 110 km/orë. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi bëri të ditur më 26 korrik 2021, se, "falë modernizmit dhe procesit të standardizimit të mjeteve, pajisjeve dhe armatimit me ato të vendeve aleate, prej 3-4 vitesh ato kanë hyrë në përdorim edhe në Forcat tona të Armatosura, ku kanë kontribuar ndjeshëm në mekanizmin e batalionit II të Këmbëorisë, si një strukturë e gatshme për NATO-n, kudo dhe kurdo". Gjithashtu tha Peleshi, "Topi 20M621, i telekomanduar në distancë (NARWHAL, Naval Remote Weapon Highly Accurate Lightweight), i prodhuar nga kompania franceze Nexter, është një armatim që kryesisht ka për qëllim mbrojtjen e anijeve". "Topi 20 mm është lehtësisht i manovrueshëm dhe ka një saktësi mbresëlënëse edhe në det me dallgë, çka është provuar edhe nga anijet tona të klasit "Iliria", të cilat vitet e fundit janë pajisur me armatimin e ri, si pjesë e projektit për modernizimin e Forcës Detare", u shpreh Peleshi.

Shqipëria i dorëzon Bullgarisë kryesimin e iniciativës rajonale SEDM

Mbi bazën e rotacionit, që nga 1 korriku 2021, Ministria e Mbrojtjes e Bullgarisë është kryetare e Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore (SEDM Process). Shqipëria i ka dorëzuar Bullgarisë stafetën për drejtimin e Iniciativës Rajonale të Southeastern Europe Defence Ministerial (SEDM), pas një periudhe të suksesshme që ajo mbajti kryesimin nga viti 2019 deri në 2021. Për këtë, Sekretariati i SEDM-Ç/PMSC mori pjesë në Takimin Koordinues, në Sofje, Bullgari. Bisedimet janë përqendruar mbi thellimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe në vështirësitë e mbajtjes së takimeve të rregullta me prani për shkak të pandemisë. Delegacioni i Sekretariatit të SEDM-Ç/PMSC kryesohej nga z. Gjergji Methoxha, drejtor i Drejtorisë së Politikave të NATO-s dhe BE-së dhe njëkohësisht drejtor i Sekretariatit të SEDM.

Takimi midis dy Delegacioneve u fokusua në anën procedurale të përgatitjes dhe zhvillimit të takimeve të Komitetit Koordinues (SEDM-Ç) dhe Komitetit Drejtues Politik-Usharak (PMSC), mbi punën dhe arritjet e Sekretariatit të SEDM gjatë periudhës 2019-2021 si dhe mbi dorëzimin e arkivit të SEDM dhe materialeve të tjera në kuadër të kësaj Iniciative.

Ceremonia zyrtare për dorëzimin dhe marrjen e kryesimit të Sekretariatit të SEDM nga Bullgaria, u zhvillua në Kumanovë, Maqedoni e Veriut (vendi ku është dislokuar Brigada e SEEBRIG), periudhë e cila përkon edhe me 22-Vjetorin e SEEBRIG HQ.

Në kuadër të kësaj vizite zyrtare, Delegacioni i Sekretariatit SEDM-



Iniciativa Rajonale e SEDM e themeluar në vitin 1996 në Tiranë, me pjesëmarrjen e gjithë vendeve të Europës Juglindore, është një proces integrimi dhe bashkëpunimi në fushat e sigurisë dhe të mbrojtjes rajonale



Ç/PMSC, vizitoi dhe SEEBRIG HQ në Kampin "Boro Menkov" në Kumanovë, Maqedonia e Veriut.

Gjatë kësaj vizite, Sekretariati i SEDM pati një takim me komandan-



tin e SEEBRIG HQ, gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos. Drejtori i Sekretariatit, nënvizoi faktin se SEEBRIG është një histori suksesi, pasi është një nga nismat e para dhe të rëndësishme, që janë ndërmarrë në rajonin tonë dhe ka kontribuar shumë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal, në besimin reciprok dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis vendeve të Europës Juglindore. Iniciativa Rajonale e SEDM e themeluar në vitin 1996 në Tiranë, me pjesëmarrjen e gjithë vendeve të Europës Juglindore dhe SHBA-së, paraqet tashmë një proces të integritit dhe të bashkëpunimit në fushat e sigurisë dhe të mbrojtjes rajonale.

Ushtarakët tanë në misionet ndërkombëtare të NATO-s

Kontingjenti VIII i EOD, pjesë e misionit të Prezencës së Përparuar “eFP” në Letoni, kthehet në Atdhe

Pas përfundimit të misionit në Afganistan, misioni i Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO-s në Letoni, ngelet një nga angazhimet tona kryesore Euro-Atlantike

Në mjesditet e Batalionit të Xhenios është zhvilluar më 8 korrik 2021, ceremonia e pritjes së kontingjentit të VIII të EOD, pjesë e misionit të Prezencës së Përparuar “eFP”, në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm zëvendëshefe e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajore Manushaqe Shehu, e shoqëruar nga shefi i shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela. Në përshëndetjen drejtuar efektivit të kontingjentit të sapo kthyer nga misioni, gjeneralmajor Shehu i përgëzoi për kontributin e vyer në shërbim të paqes dhe sigurisë, si pjesë e NATO-s. Gjithashtu, gjeneralmajor Shehu përcolli vlerësimet dhe përshëndetjen në emër të ministrit të Mbrotjtjes dhe shefit të

Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, për kryerjen me përkushtim, profesionalizëm, nder dhe dinjitet të detyrës fisnike duke i shërbyer vendit në vijën e parë të frontit të Aleancës. “Pas përfundimit dhe mbylljes me sukses e nder të plotë të kontributeve tona në misionet e vështira të Afganistanit, misioni i Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO-s në Letoni, ngelet një nga angazhimet tona kryesore Euro-Atlantike në kuadër të Aleancës”, tha zëvendëshefe e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajore Manushaqe Shehu. Ndërkohë me 1 korrik 2021, është zhvilluar ceremonia e përcjelljes së Kontingjentit të 10-të EOD të Batalionit të Xhenios, në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni, nën drejtimin e Komandës së Grup Batalionit Kanadez, i cili përkonte edhe me 53-vjetorin e krijimit të armës së xhenios.





Kthehet kontingjenti i 8-të EOD nga Letonia

Ju keni fituar besimin e plotë të drejtueseve kanadezë

Gjeneral Major Manushaqe SHEHU
Zv/Shefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së

Është privilegj e kënaqësi kur mblihdemi dhe takohemi bashkërisht për raste të tilla të gëzuara, siç është edhe kjo e sotmja, sidomos në këtë batalion që është ndër repartet më të dalluara të Forcave të Armatosura në kontributin, jo vetëm ndaj emergjencave civile në vend, por prej disa vitesh edhe me kontribute reale në ruajtjen e sigurisë globale si pjesë e Aleancës së NATO-s. Prandaj dëshiroj që fjalën time ta filloj duke i uruar efektivitetin të Kontingjentit të 8-të të Misionit në Letoni, mirëseardhjen në atdhe, pranë familjeve, njerëzve të dashur dhe kolegëve të tyre. Në emër edhe të Ministrit të Mbrojtjes Z. Niko Peleshi dhe të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Gjeneral-major Bajram Begaj, po ju sjell falënderimet dhe vlerësimet më të larta për kryerjen me profesional-

izëm, nder dhe dinjitet të detyrës tuaj fisnike. Përkushtimi juaj për t'i shërbyer vendit në vijën e parë të frontit të Aleancës është krenari dhe lavdi për ju, për familjet tuaja dhe për gjithë Forcat e Armatosura.

Ne gjithmonë e kemi pasur dhe e kemi të sigurt suksesin në këtë mision, sepse kemi bindje dhe besim të plotë në përgjegjësinë, përkushtimin dhe profesionalizmin e efektivëve si ju. Ju, ashtu sikurse edhe kolegët tuaj të kontingjenteve paraardhëse në këtë mision të rëndësishëm, me aftësitë, shërbimin, kontributin, por edhe me sakrificën sublimë, keni treguar vlera dhe keni fituar respektin e besimin e plotë të komanduesve e drejtuesve kanadezë të këtij misioni, kolegëve tuaj të NATO-s dhe të partnerëve tanë atje. Kjo është një krenari dhe dinjitet i shtuar për të gjithë ne, Forcat e Armatosura dhe për vendin.

Pas përfundimit dhe mbylljes me sukses e nder të plotë të kontributeve tona në misionet e vështira të Afganistanit, misioni i Prezencës së

Përparuar të Përforcuar të NATO-s në Letoni, ngelet një nga angazhimet tona kryesore Euro-Atlantike në kuadër të Aleancës. Për këtë arsye, ky mision do të ketë një vëmendje dhe mbështetje të veçantë të autoriteteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Pjesë dhe vlerë e rëndësishme, jetike dhe organike e kësaj vëmendje është edhe mbështetja, bashkëpunimi dhe durimi i familjeve tuaja gjatë shërbimit tuaj në këtë mision. Prandaj, asnjëherë nuk do të jetë e tepërt të shprehim falënderimet, mirënjohjen dhe respektin për familjet tuaja, për familjet e gjithë ushtarakëve, për mirëkuptimin që tregojnë dhe sakrificën që bëjnë në këto raste.

Duke ju përshëndetur dhe falënderuar edhe një herë për përmbushjen me sukses të detyrave tuaja në misionin në Letoni, ju uroj pushime të këndshme dhe të merituar me njerëzit tuaj të dashur dhe rikthim të mirëpritur në detyrat dhe shërbimin tuaj të zakonshëm ushtarak.



Kontingjenti Shqiptar është nën drejtimin e Komandës të Batalionit Kanadez

Niset drejt Letonisë, Kontingjenti i 10-të EOD i Batalionit të Xhenios

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë me 1 korrik 2021, në ceremoninë e përcjelljes së Kontingjentit të 10-të EOD të Batalionit të Xhenios, në operacionin ushtarak të NATO në Letoni, nën drejtimin e Komandës të Grupit Batalionit Kanadez, i cili përkon edhe me 53-vjetorin e krijimit të armës së xhenios.

Në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni, SHSHPFA, gjeneralmajor Begaj pasi falënderoi të pranishmit theksoi se profesionalizmi i treguar, trajnimet me aleatët dhe eksperiencat nga misionet e kaluara, e kanë bërë strukturën EOD një strukturë të besueshme, profesionale dhe specialitet "niche" siç e quan NATO, për Forcat e Armatosura dhe Shqipërinë e aftë të kryejë detyra shumë të vështira.

"Si unë edhe ministri i Mbrojtjes ndihemi krenarë me ju, kur dëgjojmë vlerësimet pozitive nga homologët tanë gjatë takimeve të nivelit të lartë në NATO. Të



EOD është një strukturë të besueshme, profesionale sipas standarteve të NATO-s, e aftë të kryejë detyra shumë të vështira

njëjtën gjë u përcoll edhe nga autoritetet letoneze gjatë vizitës së ministrit të Mbrojtjes në Letoni në fillim të muajt qershor. Unë kam besim që dhe personeli i këtij kontingjenti do të jetë në lartësinë e detyrës që i është ngarkuar dhe do të mbajë lart dhe me krenari flamurin kombëtar në Letoni." - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj.

Më tej gjatë fjalës së tij, SHSHPFA u ndal dhe në rëndësinë që ka jo vetëm prezencën e kontingjentit, por edhe promovimi i paqes duke dhënë një mesazh të qartë ndaj kundërshtarëve të NATO për gatishmërinë e Shqipërisë për përmbushjen e Nenit 5 të NATO-s. "Imazhi juaj, realizimi i detyrave që nga ato rutinë

dhe operacionale kërkojnë një vëmendje të shtuar, gatishmëri të lartë dhe profesionalizëm."

Gjeneralmajor Begaj gjithashtu adresoi një falënderim të veçantë për të gjithë burrat dhe gratë që kanë shërbyer në këto njësi dhe respekt pafund për ata heronj që kanë rënë në krye të detyrës për të na bërë ne më të sigurt.

Duke përfunduar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj i siguroi ata dhe familjarët e tyre se do të kenë në çdo çast mbështetjen dhe përkujdesjen e Shtabit të Përgjithshëm të FA, por edhe të tijën personalisht, për të arritur rezultatet më të mira në përmbushjen e misionit të tyre dhe u uroi suksese dhe kthim shëndosh e mirë në atdhe.

Bashkëpunimi ynë me Turqinë në fushën ushtarake do të vazhdojë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, priti më 14 korrik 2021, në një takim pune atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë të akredituar në vendin tonë, kolonel Muhammet Kelami Kablay.

Në takim u vlerësua bashkëpunimi ushtarak dy-palësh në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në rajon dhe më gjerë në kuadër të misioneve dhe aktiviteteve të NATO.

Midis të tjerave, gjeneralmajor Begaj shprehu falënderimet ndaj Forcave të Armatosura të Turqisë për mbështetjen shumëvjeçare të ushtarakë shqiptarë pjesëmarrës në misionin "Resolute Support Mission-Afghanistan" dhe në veçanti, në sigurimin e transportit strategjik për trupat dhe pajisjet e kontingjenteve shqiptarë gjatë dislokimit në Kabul, më së fundmi e konkretizuar edhe gjatë



Bashkëpunimi konsiston në trajnimin e arsimimin ushtarak, infrastrukturën logjistike, angazhimin e përbashkët në operacionet dhe stërvitjet në kuadër të Aleancës, etj.

fazës së kthimit në atdhe në përmbyllje të misionit në muajin qershor 2021.

Në përfundim, të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin qëndrim për thellimin e bashkëpunimit në fushën e trajnimit dhe arsimimit ushtarak, përmirësimit të infrastrukturës logjistike dhe kapaciteteve për përballimin e emergjencave civile, si dhe angazhimeve të përbashkëta në operacionet dhe stërvitjet në kuadër të Aleancës.

Takimi me atasheun ushtarak

të Turqisë vjen pas takimit dy-palësh midis shefave të Shtabit të Përgjithshëm të dy vendeve të zhvilluar gjatë konferencës vjetore të shefave të shtabit të vendeve të Ballkanit (BCHOD), në muajin qershor 2021. Ndërkohë para pak ditësh, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj ka zhvilluar një bisedë telefonike me homologun e tij turk gjeneral Yaşar Güler, ku sipas njoftimit të lëshuar nga Forcat e Armatosura Turke (TSK), janë shkëmbyen mendime mbi zhvillimet aktuale.



Ekzistojnë mundësi bashkëpunimi dy-palësh në fushën e mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, në një takim kortezie ambasadorin e Japonisë, të akredituar në vendin tonë, sh.t.z. Mitsuyuki Takada. Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit diskutuan për qasjen e përbashkët që kanë të dy vendet ndaj sfidave të sigurisë duke qenë partnerë në kuadër të aleancave me vlera demokratike perëndimore, si dhe ndanë të njëjtat mendime lidhur me kërcënimet dhe rreziqet e reja me të cilat përballen vendet dhe rolin që duhet të kenë Forcat e Armatosura për përballimin e tyre. SHSHPFA, gjeneralmajor Begaj e falenderoi ambasadorin Takada për përpjekjet e tij në forcimin e lidhjeve midis dy vendeve, si dhe vlerësoi kontributin e Japonisë me projekte rindërtimi në operacionet e drejtuara nga aleanca e NATO, veçanërisht në Afganistan. Ambasadori i Japonisë vlerësoi rolin e Shqipërisë në sigurinë e rajonit dhe më gjerë, duke nënvi-



zuar mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen. Në përfundim të takimit gjeneralmajor Begaj pasi i uroi ambasadorit Takada suksese në detyrën e tij, e siguroi atë mbi gatishmërinë e FARSH për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit dy-palësh në fushën

e mbrojtjes, kryesisht në përballimin e emergjencave civile. Z. Takada mori detyrën e ambasadorit të Japonisë në Shqipëri në muajin nëntor 2020 dhe është ambasadori i dytë pas hapjes së Ambasadës së Japonisë në janar 2017.

Gjeneralmajor Bajram Begaj priti atashetë ushtarakë francezë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj priti në 26 korrik 2021, në një takim kortezie kolonel Fabrice Duda, me rastin e përfundimit të detyrës si atashë ushtarak i Republikës së Francës, i akredituar në Shqipëri, si dhe kolonel Nicolas Coussiere, i sapo emëruar në këtë detyrë. Gjatë takimit, gjeneralmajor Begaj vlerësoi përpjekjet dhe punën e kolonel Duda, për rritjen e bashkëpunimit midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, gjatë kohës së qëndrimit në detyrë. Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj i uroi suksese në detyrën e sapo marrë kolonel Coussiere, duke e garantuar për gatishmërinë e FARSH në thellimin e bashkëpunimit midis dy vendeve, e veçanërisht në fushën e arsimimit ushtarak.

Nga ana e tij kolonel Duda pasi shprehu kënaqësinë dhe mbresat gjatë qëndrimit si atashë ushtarak në Shqipëri, falenderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH

Kolonel Fabrice Duda mbaron mandatin, vjen kolonel Nicolas Coussiere



për mbështetjen e dhënë në kryerjen e detyrës, duke vlerësuar në veçanti nivelin e lartë profesional të ushtarakëve shqiptarë të cilët janë diplomuar në Kolegjin e Luftës në Francë.

Kolonel Coussiere nën cilësinë e marrësit të detyrës, siguroi se bashkëpunimi midis dy zyrave për-

katëse do të vazhdojë në të njëjtin nivel dhe intensitet. Në përfundim të takimit, gjeneralmajor Bajram Begaj, i uroi kolonel Duda suksese të mëtejshme në karrierën ushtarakë dhe i akordoi një çertifikatë mirënjohjeje në shenjë falenderimi për kontributin e tij.

Intervistë me kolonel Ahmet Leka drejtor i IKSHU

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, si një strukturë e re Akadematike, produktet dhe vizioni

Ky institut është ngritur mbi bazën e përvojës më të mirë të institucioneve pararendëse, me përvojë disavjeçare të kërkimit në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, teorisë doktrinare dhe stërvitjes.

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

“Doktrina Ushtarake hartohet dhe zhvillohet duke u bazuar në Strategjinë e Sigurimit Kombëtar dhe Strategjinë Ushtarake të RSH. Ajo evoluon në përgjigje të ndryshimit të politikave, të kapaciteteve moderne luftarake dhe/ose të mënyrës së përdorimit të forcës ushtarake”. Mbi bazën e përvojës disavjeçare të kërkimit në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, teorisë doktrinare dhe stërvitjes, por dhe në kuadër të ristrukturimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, u krijua Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU), me profil kërkimor shkencor dhe eksperimentues. Drejtori i IKSHU-së, kolonel Ahmet Leka,

dha një përgjigje për interesimin tonë.

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, është strukturë e re e AFA-së, e ngritur pas ristrukturimit të saj. Cili është roli, vendi dhe misioni i IKSHU në FA?

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU) është krijuar në kuadrin e ristrukturimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, me VKM nr.156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj”. Ky institut është ngritur mbi bazën e përvojës më të mirë të institucioneve pararendëse, me përvojë disavjeçare të kërkimit në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, teorisë doktrinare dhe stërvitjes si, Qendra e Doktrinės dhe Manualeve 2001; Qendra e Analizave të Mbrojtjes, 2009; Qendra e Doktrinės 2012; Qendra e Simulimit 2012; Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes 2013; si dhe Qendra e Doktrinės dhe Kërkimit 2014. IKSHU është njësi kryesore e AFA me profil kërkimor shkencor dhe eksperimentues, dhe mbështet vendimmarrësit në nivel strategjik, operacional, taktik dhe aktivitetin e FA-ve nëpërmjet monitorimit dhe analizës së sfidave në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare; hartimit të skenarëve operacionalë dhe strategjikë dhe kontributit në RSM; zhvillimit/hartimit të publikimeve doktrinare që normojnë dhe rregullojnë aktivitetin e FA; aplikimin e testimeve, analizave dhe vlerësimeve të stërvitjeve reale dhe me simulim.

Cila do të jetë qasja e Institutit, si do të fokusohet puna e tij në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në sfidat e



sotme por dhe të së ardhshme? Çfarë produktesh ofron IKSHU?

Po e nis nga produktet, që mod-estisht e them se ato do të jenë vërtet sfiduese, por jo të parealizueshme. Dhe disa nga produktet që prezanton Instituti janë: Studime të karakterit kërkimor-shkencor në fushat e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, që i paraprijnë mjedisit strategjik dhe dhënies së ekspertizës drejtimit civil dhe ushtarak të Republikës së Shqipërisë; Dhënie ekspertize dhe pjesëmarrje në formulimin e dokumenteve kryesore strategjike, si: Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake, Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA. IKSHU është struktura kryesore që mundëson hartimin e publikimeve doktrinare të unifikuara dhe të harmonizuara të aplikueshme në interes të FA. Ajo zhvillon dhe integron lidhjen hierarkike dhe organike midis dokumenteve kryesore strategjike kombëtare me ato doktrinare, duke filluar nga Doktrina e Përbashkët e FARSH dhe doktrinave të forcave, rregulloreve, manualeve, koncepteve bazë të përdorimit të forcave, integrimin e sistemit të standardizimit dhe mësimave të nxjerra, procedurave të drejtimit e të zhvillimit të operacioneve, në përputhje me ato të NATO-s. IKSHU, në fokusin e tij do të ketë ushtrimin e misionit dhe përgjegjësi të tij në përgjigje të sfidave të së ardhmes në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, me kohezion, analizë të thelluar të situatave të sigurisë, produkte shkencore efektive, dhënien e ekspertizës për autoritetet vendimmarrëse, përjasje të zhvillimit doktrinar në interes të FA. IKSHU është strukturë e AFA që me punën e tij kontribuon në aspektin e kërkimit shkencor dhe doktrinar, nëpërmjet projekteve shkencore si "Revistën Ushtarake", si i vetmi organ teoriko-shkencor i Akademisë së forcave të Armatosura, konferencave, seminareve, workshopeve, studimeve dhe analizave të ndryshme. Të gjitha produktet kërkimore të tij vihen në dispozicion të institucioneve dhe autoriteteve të interesuara ushtarake dhe/ ose civile të sigurisë dhe mbrojtjes, sipas planit të parashikuar. Kjo rregullore është akt detyrues për personelin që përfshihet në strukturën e saj. Ajo e shtrinë veprimtarinë brenda kuadrit ligjor dhe akteve normative për-

katëse. Duhet të theksojmë se një produkt periodik shkencor do të jetë "Revista Ushtarake", ku IKSHU do të drejtojë veprimtarinë për përgatitjen dhe publikimin e këtij projekti, por dhe publikimeve të tjera shkencore, doktrinarë dhe mësimore.

Le të ndalemi pak tek puna Institutit lidhur me ekspertizën që jep në përgatitjen e ligjeve, dokumenteve strategjike dhe doktrinar, a përbëjnë ato bazën e zhvillimit dhe dhe reformimit në fushën e mbrojtjes?

Shqipëria është vend anëtar i NATO, ndaj dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo janë të pasqyruara më së miri në një paketë të plotë për ndryshime ku përfshihen rishikimi i kuadrit ligjor, dokumenteve strategjike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, ristrukturimi i strukturës së forcës dhe zhvillimi i doktrinës ushtarake. Reforma ligjore ka në themel rishikimin e të gjitha akteve që rregullojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura në përputhje me stadin aktual dhe perspektiv të reformave në fushën e mbrojtjes. Aktualisht po punohet për përgatitjen e dokumenteve si Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura. Pjesë e pandarë është dhe Rishikimi i Strukturës së Forcave të Armatosura, i cili do të synojë në ndërtimin e kapaciteteve operacionale të nevojshme për arritjen e nivelit të ambicies të Forcave tona të Armatosura të shprehura në Dokumentin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. Struktura e forcës së ardhme do ndërtohet duke balancuar kapacitetet e kërkuara operacionale dhe mbështetëse me burimet e vëna në dispozicion të mbrojtjes. Reforma në fushën e doktrinave dhe koncepteve bëhet në kuadër të kësaj pakete dhe paralelisht me reformat tjera. Rishikimi dhe hartimi i doktrinës ushtarake dhe doktrinave të forcave bëhet në zbatim të ndryshimeve themelore politike e strategjike, mjedisit të sigurisë, ndryshimeve strukturore të FA, karakterit të ndryshueshëm të operacioneve, teknologjisë së re, mësimave të nxjerra në kryerjen e operacioneve brenda dhe jashtë vendit. Ky rishikim bëhet me qëllim që në të gjejnë pasqyrim të plotë konceptet, procedurat dhe detyrimet që duhet të përmbushin Forcat tona të Armatosura në

operacione, të cilat burojnë nga dy realitete cilësisht të reja: së pari, anëtarësimi i vendit tonë në NATO dhe, së dyti, ndryshimet e reja në strukturën organizative të Forcave të Armatosura.

Kemi mësuar se në muajin nëntor ju keni planifikur një konferencë shkencore, kush është objekti? Çfarë qëllimi dhe çfarë synimi ka kjo konferencë?

Po tashmë ne e kemi anonçuar. Akademia e Forcave të Armatosura, nëpërmjet Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU), më 25 nëntor 2021 organizon Konferencën Shkencore me temë "Mjedisi dhe sfidat e sigurisë-ndikimi në sigurinë rajonale dhe kombëtare". Objekt i punës së kësaj konference, do të jenë zhvillimet gjeopolitike dhe ushtarake në Ballkanin Perëndimor (BP), si dhe interesat strategjike të aktorëve kryesorë ndërkombëtarë, që veprojnë dhe kanë interesa në rajonin tonë.

Cilat janë ndikimet e këtyre zhvillimeve në raport me sigurinë dhe nismat rajonale të sigurisë, të vlerësuara si shumë të rëndësishme për paqen dhe stabilitetin afatgjatë të Ballkanin Perëndimor?

Vendet e Ballkanit Perëndimor, pas disa dhjetëvjeçarësh luftë dhe situatash të paqëndrueshme të sigurisë, po përpiqen të orientohen drejt marrëdhënieve më harmonike me njëri-tjetrin. Me gjithë veçantitë e tyre, këto vende kanë të njëjtën qasje dhe perceptim, sa i takon rreziqeve, kërcënimeve dhe sfidave të sigurisë. Edhe pse kështu, asnjë pjesë e hapësirës euroatlantike dhe rajonale, përfshirë Shqipërinë, nuk është e sigurt nga kërcënimet bashkëkohore. Kërcënimet janë komplekse, shumëplanëshe dhe subjekt i ndryshimeve të paparashikuara, që ndryshojnë ndjeshëm natyrën, intensitetin dhe ndikimin ndaj sigurisë. Këto sfida kërkojnë akte, veprime si dhe qasje "të mençura" bazuar në zgjidhjet ndërshtetërore dhe rajonale. Gjetja e qasjeve të përbashkëta, mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe zhvillimi i projekteve të ndryshme me interes reciprok në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, është domosdoshmëri jetike për rajonin dhe secilin vend. Në këtë kontekst, do trajtohen sidomos bashkëpunimi

në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Në ndryshim nga vendet tjera të rajonit, ne kemi të përbashkët jo vetëm objektivat strategjikë kombëtarë të integritetit euroatlantik, por edhe interesat jetikë kombëtarë, siç janë integriteti territorial dhe identiteti kombëtar. Fluksi i azilkërkuesve dhe imigrantëve të parregullt që përdorin Shqipërinë si rrugë tranziti për në vendet e BE-së, mbart rrezikun që elementët terroristë të synojnë hyrjen në territorin e Shqipërisë. Në këtë pikëpamje, Akademia e Forcave të Armatosura, nëpërmjet Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU), ka planifikuar zhvillimin e kësaj konference. Konferenca do të mundësojë shkëmbimin e pikëpamjeve dhe perspektivave tona në nivel kombëtar, por dhe rajonal, nëpërmjet shkëmbimit të praktikave dhe përvojave më të mira në interes të bashkëpunimit të mëtejshëm. Ftojme akademikë, studiues nga institucionet e kërkimit shkencor apo strukturat e sigurisë brenda vendit, si dhe individë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të marrin pjesë.

Cili do të jetë përfaqësimi në këtë konferencë?

Konferenca zhvillohet dhe drejtohet nga një Bord Shkencor i përbërë nga anëtarë të spikatur në fushat akademike, kërkimore e shkencore, nën drejtimin e gjeneralmajor Prof Asoc. Bajram Begaj, shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA. Në audiencën e kësaj konference do të ketë akademikë, studiues nga institucionet e kërkimit shkencor apo strukturat e sigurisë brenda vendit, si dhe individë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.

Ky projekt duket vërtet ambicioz dhe me interes, por që gjithashtu kërkon edhe një përgatitje dinjitoze. Mund të na thoni se deri ku jeni, çfarë punë është bërë deri tani dhe çfarë ka mbetur për tu bërë?

Puna më e madhe ka mbaruar dhe tani jemi në përgatitjet e fundit. Është përgatitur e miratuar platforma dhe plani i masave për përgatitjen dhe zhvillimin konferencës shkencore, është përgatitur dhe miratuar nga Këshilli Shkencor

tematika orientuese e konferencës dhe është dërguar në strukturat e FARSH, institucionet e arsimit të lartë, struktura homologe, strukturat shtetërore, si dhe po behet një kalkulim për të ftuar dhe institucione ndërkombëtare me qëllim që konferenca të jetë e karakterit rajonal.

Mund të zbulojmë diçka për lexuesit rreth tematikave, ku do të orientohet konferenca?

Duhet thënë që në fillim të herës se në "Thirrjen për punime shkencore", është përcaktuar dhe tematika orientuese e punimeve të kësaj konference. Kryesisht konferenca do të orientohet të trajtojë, (por pa u kufizuar) tematika si Rreth mjedisit



të sigurisë - sfidat për rajonin e Ballkanit Perëndimor, mundësitë për forcimin e aftësive të institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes, nëpërmjet bashkëpunimit mes aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë të brendshëm dhe më gjerë, duke siguruar një qasje sa me gjithëpërfshirëse; Sfidat e ardhshme të sigurisë së RSH, nën moton e NATO-s "Vizion 2030-të bashkuar për një epokë të re". Cilët janë objektivat strategjikë kombëtarë të integritetit euroatlantik dhe interesat jetikë kombëtarë, që lidhen me integritetin territorial dhe identitetin kombëtar. Sfidat e mbrojtjes kibernetike do të jetë aspekt tjetër i trajtimit të konferencës, duke vlerësuar se implikimet e evolucionit të kërcënimeve kibernetike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, përbëjnë një emergjencë për mjedisin e sigurisë dhe Mbrojtjen kibernetike (CyberDefence). Një vend të veçantë konferenca do

ti kushtojmë faktorëve që ndikojnë mjedisin e sigurisë që lidhen me ekstremitetet e natyrës dhe sëmundjet pandemike, duke marrë si referencë COVID-19. Konferenca do të trajtojë edhe çështje të tjera që lidhen kryesisht me sigurinë e shteteve të vogla, bashkëpunimin e tyre, sfidat e integritetit për të ardhmen, ndikimi arsimor dhe kulturës në siguri etj.

Edhe një pyetje të fundit, si do të realizohet bashkëpunimi me strukturat kryesore të FARSH dhe ato jashtë tyre?

Bashkëpunimi do të realizohet nëpërmjet, projekteve të bashkëta kërkimore-shkencore,

ngritjes së grupeve të ndryshme të përbashkëta, bashkëorganizimit të veprimtarive shkencore të përbashkëta si, revista shkencore, konferenca, workshope, seminare, hartimit të doktrineve, si dhe produkte e të tjera të përbashkëta në dhënie ekspertize për SSK, SU, projekt-ligje, apo dokumente të tjera të përcaktuara në ndihmë të strukturave të FA. Një anë tjetër e bashkëpunimit do të jetë puna nëpërmjet njohjes me informacionin shkencor dhe metodologjinë se përdorur në punën shkencore nga institucionet homologe, kryerja e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore me ta, si dhe shkëmbim personeli për pasurimin e përvojës akademike e kërkimore të tyre. Anëtarësimi në organizata, rrjete apo organizma të tjerë në përputhje me misionin, detyrat dhe platformën zhvillimore të IKSHU dhe AFA do të jetë një prioritet yni.

FT ka realizuar me sukses stërvitjen “Defender Europe 21”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë me 8 korrik, në analizën 6-mujore të zhvilluar nga Komanda e Forcës Tokësore, e cila u zhvillua në mjediset e kësaj force. Pasi vlerësoi punën e bërë nga Komanda e Forcës Tokësore, gjeneralmajor Begaj vuri theksin në faktin se edhe pse të kush-tëzuar nga pandemia, FARSH ia dolën të realizojnë me sukses objektivat e vëna dhe të përmbyllin me sukses një nga stërvitjet më të mëdha siç ishte “Defender Europe 21”.

“Stërvitja shumëkombëshe “Defender-Europe 21”, e cila ishte një ndër stërvitjet më të mëdha të re-

alizuara ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ishte një platformë ideale për rritjen e ndërve-prueshmërisë si dhe testimin e kapaciteteve operacionale të njësisë kryesore të Forcave tona të Armatosura dhe me këtë rast dua t’ju përgëzoj për profesionalizmin dhe disiplinën e treguar gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të kësaj stërvitjeje...”, u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj. Në përfundim të analizës, shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj u uroi suksese të mëtejshme për realizimin e objektivave për vitin 2021 edhe përgjatë 6-mujorit të dytë.



NË MJEDISËT E QENDRËS STËRVITORE PASHALIMAN

Përfundon Kursi i Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA)

Në mjediset e Qendrës Stërvitore Pashaliman, u zhvillua më 14 korrik, ceremonia e ndarjes së certifikatave në përfundimit të Kursit të Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA) specialiteti Detari. Kursit SIA zgjati 10 javë dhe gjithsej ishin pjesëmarrës 18 kursantë detar profesionist. Gjatë kësaj periudhe kursantët janë njohur dhe kanë ndjekur programin teorik dhe praktik mësimor nga qendra stërvitore si ajo e rregulloreve dhe mirëmbajtja e anijeve, lufta kundër ujit dhe zjarrit si dhe praktika detare. Nga kursantët është treguar disiplinë e lartë dhe korrektësi në zbatimin e rregulloreve bazë të Forcave të Armatosura. Komandanti i Qendrës Stërvitore Pashaliman, kapiten i rangut II Barnir Likaj, në përfundim të ceremonisë u uroi suksese pjesëmarrësve dhe dijet e marra t’i përdorin në të ardhmen në repartet e tyre.

Në Komandën e Forcës Detare

Atasheu ushtarak i Kosovës, viziton Komandën e Forcës Detare

Më 14 korrik 2021, atasheu i Republikës së Kosovës në vendin tonë, kolonel Bashkim Shillova, zhvilloi një vizitë në Komandën e Forcës Detare. Kolonel Shillova u prit nga komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia dhe shefi i Shtabit të FD, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj. Gjatë takimit u nënvizua bashkëpunimi i ngushtë midis dy shteteve dhe dy ushtrive.

Në takim u diskutua mbi realizimin e aktiviteteve të planit të bashkëpunimit ushtarak për vitin 2021 dhe perspektiva e bashkëpunimit

për të ardhmen, si dhe bashkëpunimi ndërmjet zhytësve tanë të Qendrës së Zhytjeve Pashaliman me pjesëtarët e FSK do të vazhdojë edhe në të ardhmen ashtu si deri tani në operacione të ndryshme. Në fund të takimit gjeneral brigade Xhebexhia dhe kolonel Shillova theksuan se, kjo



frymë miqësore e bashkëpunimi do vazhdojë edhe në të ardhmen midis FSK e FD.

30 anije luftarake, 3 aeroplanë, 8 helikopterë dhe 2.065 ushtarakë

Në Varna zhvillohet stërvitja detare ndërkombëtare “Breeze 2021”

Marrin pjesë 14 vende: Shqipëria, Bullgaria, Belgjika, Britania e Madhe, Gjeorgjia, Greqia, Spanja, Italia, Letonia, Polonia, Rumania, SHBA, Turqia dhe Ukraina

Nga data 11 deri më 19 korrik 2021, Forcat Ushtarake Detare të Bullgarisë po zhvillojnë stërvitjen e madhe detare ndërkombëtare “Breeze 2021”. Në këtë stërvitje janë përfshirë 14 vende me 30 anije dhe motoskafë luftarakë, 3 aeroplanë, 8 helikopterë dhe 2.065 ushtarakë nga Shqipëria, Belgjika, Britania e Madhe, Gjeorgjia, Greqia, Spanja, Italia, Letonia, Polonia, Rumania, SHBA, Turqia, Ukraina, Grupi i Dytë i Përhershëm Ushtarako-Detar i NATO-s dhe Grupi i Dytë i Përhershëm i Veprimit ndaj Minave i NATO-s nga Forcat e Reagimit të Aleancës. Bullgaria merr pjesë me 16 anije dhe motoskafë luftarakë, 2 aeroplanë, 3 helikopterë dhe 860 veta personel, ekipe mjekësorë dhe ekipe shtabi. Stërvitja ishte planifikuar dhe po zhvillohet



në përputhje me standardet dhe procedurat e NATO-s dhe ishte e hapur për pjesëmarrjen e Marinës nga vendet anëtare të Aleancës.

Selia e drejtimit të stërvitjes është vendosur në bazën Varna të Flotës së anijeve luftarake dhe anijeve mbështetëse bullgare.

Garnizoni i Flotiljes Detare Pashaliman

Batalioni i Forcave Speciale u dislokua në garnizonin e Flotiljes Detare Pashaliman, ku ka zhvilluar stërvitjen fushore/ujore “Pashalimani 21”. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte rritja e kushteve fizike të personelit, përvetësimi i teknikave të notimit, i teknikave për kalimin e pengesave ujore, si dhe aftësimi i përdorimit të mjeteve lundruese me dhe pa motor në interes të përballimit të emergjencave civile. Hapjen e kësaj stërvitjeje e ndoqi nga afër komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale kolonel Arben Zani, i cili përgëzoi efektivet e këtij batalioni për punën dhe përkushtimin e treguar gjatë kësaj stërvitjeje. Stërvitja “Pashalimani 21” është një nga stërvitjet fushore/ujore, e cila vijon të kryhet dhe nga repartet e tjera të Forcës Tokësore.

Përfundon stërvitja fushore-ujore “Pashalimani 21”



Tetë anije zhvillojnë stërvitjen detare dy ditore “GRUPEX 21”

Efektivë të Flotiljes Detare, në zbatim të planit vjetor të aktiviteteve të Forcës Detare, zhvilluan stërvitjen “GRUPEX 21” dhe qitjet bregdetare. Në stërvitje morën pjesë tetë anije: gjashtë anije ishin nga Grupi i Parë i Anijeve Patrulluese, përkatësisht anijet “Oriku” P-132, “Butrinti” P-134, “Shiroka” P-117, “Skënderbeu” P-112, “Mati” PO-2 dhe “Shkumbini” P-03; dy anije ishin të Grupit të Dytë të Anijeve Patrulluese, përkatësisht “Iliria P-131” dhe “Lissus P-133”. Në stërvitje gjithashtu mori pjesë edhe Grupi i Bordingut.

Stërvitja GRUPEX u zhvillua nga Komanda e Flotiljes Detare kryesisht për certifikimin e kapaciteteve të grupeve patrulluese. Gjatë stërvitjes “GRUPEX 21” u përpunuan elementët e manovrimit taktik, operacioneve të embargos detare (MIO), operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) dhe elementë të stërvitjes së furnizimit në det (RAS).

Stërvitja “GRUPEX 21” dhe qitjet bregdetare ishin të ndërthurura me njëra-tjetrën si pjesë e një skenari të përgatitur nga Shtabi i Flotiljes Detare në përputhje me qëllimin e operacioneve të sigurisë detare në detin Adriatik dhe Jon. Stërvitja GRUPEX dhe qitjet bregdetare shërbyen për kompaktësimin e veprimeve të anijeve të Flotiljes Detare në nivel grupi. Qitjet bregdetare u zhvilluan në ishullin e Sazanit, me armatimin e anijeve në poligonin e vetullore në pjesën perëndimore të Karaburunit. Efektivët artiljer/mitraljer dhe oficerët e rinj të anijeve zhvilluan qitje sipas kushteve të ushtrimeve.

Stërvitja GRUPEX dhe qitjet bregdetare u ndoqën nga komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, shefi i Shtabit të Forcës Detare, komandanti i Flotiljes Detare dhe përfaqësues të shtabit të Forcës Detare, të cilët ishin të imbarkuar në bord të anijes Butrinti për gjatë dy ditëve. Stërvitja “GRUPEX 21” dhe qitjet bregdetare u zhvilluan dhe përfunduan me sukses.

// Në stërvitje morën pjesë tetë anije: gjashtë anije ishin nga Grupi i Parë i Anijeve Patrulluese, përkatësisht anijet “Oriku” P-132, “Butrinti” P-134, “Shiroka” P-117, “Skënderbeu” P-112, “Mati” PO-2 dhe “Shkumbini” P-03; dy anije ishin të Grupit të Dytë të Anijeve Patrulluese, përkatësisht “Iliria P-131” dhe “Lissus P-133”.



Stërvitja “GRUPEX 21” është përshëndetur edhe nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, nëpërmjet facebook-ut. “8 anije me efektivë të Forcës Detare për dy ditë me radhë zhvilluan stërvitjen “GRUPEX 21” si dhe qitje bregdetare. Edhe

një herë efektivët tanë treguan profesionalizmin e tyre në element manovrimi taktik, operacioneve të kërkim-shpëtimit, operacioneve të embargos apo edhe elementëve të stërvitjes së furnizimit në det”, shkruan Peleshi në facebook.



Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Francën

Anija franceze Pluton (M662)-vizitë portuale në Portin Detar Vlorë

Anija franceze Pluton (M662) ka zhvilluar me anijen Oriku P-132 stërvitjen e përbashkët "PASSE" në përputhje me manualët e NATO-s

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Francën, nga data 1-4 korrik 2021 anija franceze Pluton (M662)-Bâtiment-Base de Plongeurs Démineurs (BBPD) zhvilloi vizitë portuale në Portin Detar Vlorë. Qëllimi i kësaj vizite ishte stërvitja dhe shkëmbimi i eksperiencës ndërmjet efektivave të anijeve, efektivave zhytës të Qendrës së Zhytjes dhe pastrimi i municioneve nënujore në gjirin e Vlorës.

Anija franceze BBPD Pluton u prit në hyrje të ujërave territoriale shqiptare nga anija Oriku, P-132. Gjatë lundrimit për në portin e Vlorës, të dyja anijet zhvilluan stërvitjen e përbashkët PASSEX, ku u përpunuan elementë të manovrimit taktik dhe furnizimit në det në përputhje me manualët e NATO. Anija franceze u prit në port nga komandanti i Flotiljes Detare kapiten i rangut II Sabri Gjinollari, zëvendësambasadorja franceze Claire Nantier, zëvendësatashu ushtarak francez, major Yann Maillard si edhe personel nga i Flotiljes Detare.

Pas bregëzimit të anijes komandanti i anijes kapiten i rangut III Barazer De Lannurien ftoi në bordin e anijes komandantin e Flotiljes Detare, kapiten i rangut II Sabri Gjinollari. Komandanti i Flotiljes Detare i uroi komandantit të anijes BBPD Pluton mirëseardhjen në vendin

tonë. Gjithashtu kapiten i rangut II Gjinollari uroi një stërvitje sa më të frytshme dhe qëndrim të këndshëm në Vlorë. Komandanti i anijes BBPD Pluton nga ana e tij falënderoi komandantin e Flotiljes Detare për pritjen dhe e njohu atë me misionin dhe detyrat që kryen anija BBPD Pluton. Gjithashtu gjatë kësaj kohe u mbajt edhe një takim ndërmjet zhytësve francezë dhe palombarëve shqiptar të Qendrës së Zhytjes, për planifikimin e zhvillimit të operacionit për heqjen e municioneve në zonën e Kalasë, Gjiri i Vlorës. Ky operacion u zhvillua gjatë gjithë kohës së qëndrimit të anijes franceze dhe në operacion u angazhuan palombarët e të dy palëve, 2 gomonet e anijes BBPD Pluton, anija Shkumbini, P-03, gomonia e anijes Oriku, P-132 si dhe gomonia e Qendës së Zhytjes.

Komandanti i anijes franceze gjatë qëndrimit në Vlorë zhvilloi një vizitë kortezie në Bashkinë e Vlorës, ku u pritën nga nënkryetarja Aulona Veizi. Zonja Veizi e njohu komandantin e anijes franceze me qytetin dhe potencialin turistik të tij.

Pas vizitës në Bashkinë e Vlorës, komandanti i anijes BBPD Pluton zhvilloi një vizitë në Bazën Detare të Pashalimanin, ku u pritën nga komandanti i Flotiljes Detare kapiten i rangut II Sabri Gjinollari dhe oficerë të shtabit. të cilët i njohën miqtë me strukturën, misionin, zhvillimin dhe modernizimin e deritanishëm të Forcës Detare në përgjithësi dhe Flotiljes Detare në veçanti. Në datën 4 korrik 2021 anija franceze BBPD Pluton u largua nga ujërat territoriale shqiptare e shoqëruar nga anija e Flotiljes Detare.



Batalioni II i Këmbësores në Rreth-Greth, si dhe Batalioni Komando në garnizonin e Flotiljes Detare, Pashaliman, kanë zhvilluar stërvitjet fushore-ujore “Adriatiku 21” dhe “Juba 21” në zbatim të matricës së stërvitjeve të Forcës Tokësore. Qëllimi i kësaj stërvitje ishte rritja e kushteve fizike të personelit, përvetësimi i teknikave të notimit, i teknikave për kalimin e pengesave ujore, si dhe aftësimi i përdorimit të mjeteve lundruese me dhe pa motor në interes të përballimit të emergjencave civile. Të dy batalionet treguan dhe njëherë se përkushtimi, përgatitja e lartë fizike dhe puna në grup janë ato që i bëjnë këto stërvitje më të lehta për t’u përballuar.

Zhvillohen stërvitjet “Adriatiku 21” dhe “Juba 21”



EOD pastron 200 municione në gjirin e Vlorës

Efektivet EOD të Komandës Mbështetëse në bashkëpunim me zhytësit e Forcës Detare dhe anijes së marinës kombëtare franceze, Pluton (M662) (Bâtiment-Base de Plongeurs Démineurs-BBPD), kanë punuar së bashku për zhvillimin e operacionit për kërkimin, gjetjen dhe nxjerrjen nga uji të municioneve në gjirin e Vlorës. Gjatë kontrollit të ushtruar në total janë zbuluar dhe nxjerrë rreth 220 municione të kalibrave të ndryshëm.

Ekipi EOD pasi mori në dorëzim municionet e gjetura, bëri transportimin e tyre në drejtim të vendit të grumbullimit të tyre, në bazën detare të Pashalimanit. Ekipi EOD ka bërë transportimin e sigurt të tyre në drejtim të depos së municioneve të Batalionit të Xhenios ku do të administrohen deri në asgjësimin përfundimtar.

Operacioni për pastrimin e municioneve nga Gjiri i Vlorës, ku mori pjesë edhe anija e marinës kombëtare franceze, Pluton (M662) është përshëndetur edhe nga Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi.

Në bashkëpunim me marinën franceze Pluton (M662)

Gjatë kontrollit të ushtruar në total janë zbuluar dhe nxjerrë rreth 220 municione të kalibrave të ndryshëm



“Gjiri i Vlorës është tashmë më i pastër dhe më i sigurt. Zhytësit shqiptarë dhe francezë nxorën nga fundi i detit rreth 220 municione të

kalibrave të ndryshëm, të cilat iu dorëzuan për asgjësim xhenierëve tanë”, shkruan ministri Peleshi në facebook.

Në bashkëpunim me Forcat Speciale amerikane

Zhvillohet stërvitja “Joint Combined Exercise Training” e koduar “JCET 21”

Marrin pjesë përfaqësues nga Zyra e Bashkëpunimit Ushtarak me SHBA dhe instruktorë nga forcat speciale amerikane “Green Berets”

Në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale, Zall-Herr, u zhvillua ditën e enjte, më 8 korrik 2021, ceremonia e fillimit të stërvitjes “Joint Combined Exercise Training” e koduar “JCET 21” e cila ka zgjatur tre javë. Në ceremoninë e fillimit të stërvitjes, mori pjesë shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Ilirjan Dauti, zëvendëskomandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale, nënkolonel Kucana, komandanti i Batalionit të Forcave Speciale nënkolonel Jata, si dhe të përfaqësues nga Zyra e Bashkëpunimit Ushtarak me SHBA dhe instruktorë nga forcat speciale amerikane ‘Green Berets’.

Kjo stërvitje u krye midis Batalionit të

Forcave Speciale shqiptare dhe Forcave Speciale amerikane dhe qëllimi i kësaj stërvitje është rritja e ndërveprueshmërisë dhe operacionalitetit të forcave speciale në luftën kundër kërcënimeve konvencionale dhe jokonvencionale gjithnjë e në rritje, si dhe shkëmbimin e eksperiencës mes trupave pjesëmarrëse në realizimin me sukses e të gjithë llojeve të operacioneve luftarake speciale.

Kjo stërvitje ka zgjatur tre javë është zhvilluar në mjediset e Batalionit të Forcave Speciale. Ndër temat kryesore të kësaj stërvitje ishin: planëzimi, zbulimi special, armatimi, xhenio, shëndetësia, patrullimi në këmbë dhe me mjete, rënia në kontakt me kundërshtarin, mbulimi dhe kamuflimi, zënia e pikës së vrojtimit, goditje objekti, etj.



Efektivi i kompanisë EOD të batalionit xhener në Komandën Mbështetëse, nga data 12 deri më 23 korrik ka zhvilluar “Mentoring Course” me instruktorë amerikanë. Përgjatë këtyre dy javëve, efektivi EOD pati mundësinë të verë në përdorim praktik të gjitha njohuritë e marra në teori gjatë kurseve EOD të nivelit të I-rë, të II-të dhe të III-të. Gjithashtu, ky personel u njoh nga trajnuesit amerikanë edhe me teknika të reja për procedurat e vënies në siguresë, të cilat përdoren gjatë operacioneve EOD. Të gjitha këto teknika për herë të parë u përdorën në municione reale duke u dhënë eksperiencë e vetëbesim operatorëve në punë. Ky kurs ishte një aktivitet tepër i veçantë, real e shumë i vlefshëm në funksion të realizimit me sukses të operacioneve EOD në të ardhmen.

Me instruktorët amerikanë në “Mentoring Course”



EOD-katër operacione për heqjen e municioneve

Ekipet EOD të Komandës Mbështetëse, gjatë javës së fundit të muajit korrik 2021, kanë realizuar me sukses 4 operacione për heqjen e municioneve të gjetura në zona urbane e rurale në Vlorë, Himarë, Korçë dhe Vorë. Operacioni i parë u krye në Vlorë, ku pas rikonicionit e vlerësimit të kryer nga ekipi EOD në zonën e quajtur plazhi I vjetër u gjet një shtimje kalibër 75 mm. Më pas operacioni vijoi në bashkinë Himarë, ku u gjet 1 shtimje 75 mm.

Operacioni i tretë u zhvillua nga një ekip tjetër EOD në bashkinë Korçë, ku u gjet 1 predhë mortaje italiane e Luftës së II-të Botërore (LIIB). Ndërsa operacioni i fundit EOD u krye me sukses në bashkinë Vorë, ku dy predha artilerie të kalibrit 125 mm u gjetën pranë zonës së Gërdecit dhe u hoqën. Të gjitha këto municione pas vlerësimeve u cilë-

Hiqen municione të paplasura në zonat rurale dhe urbane



suan si të prekshme e të lëvizshme nga ekipet EOD, të cilët morën të gjitha masat e nevojshme sipas protokollit të sigurisë dhe bënë

transportimin e magazinimit e tyre në pikën e grumbullimit të përcaktuara në këto raste në pritje për tu eliminuar.

Efektivë të këmbësorisë, trajnohen nga Garda e New Jersey-SHBA

Nga datat 5 korrik deri në 18 korrik, 14 efektivë të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë (b2k) të drejtuar nga zëvendëskomandanti i batalionit major Sajmir Gërmenji u trajnuan nga Garda e New Jersey në SHBA. Gjatë kësaj periudhe efektivët e b2k u trajnuan për tema të ndryshme si dhënia e ndihmës së parë, qendër simulimi me armët e këmbësorisë, si dhe furnizim të mjeteve fluturuese në ajër.

Ky trajnim si aktivitet i një rëndësie të veçantë, që ka impakt të jashtëzakonshëm në rritjen profesionale të efektivëve ushtarakë shqiptarë, zhvillohet në 20 - vjetorin e bashkëpunimit me Gardën e New Jersey. Trajnimi vjen rishtazi pas stërvitjes "Defender Europe 21" e cila pati një bashkëpunim të



shkëlqyer midis palëve. Njohuritë e marra nga efektivat, pjesëmarrës në këtë trajnim, do të rrisin edhe

më tej profesionalizmin dhe nivelin e gatishmërisë profesionale të këtij batalioni.

Nën Komandës së Forcave Speciale të Turqisë

Forcat Speciale marrin pjesë në stërvitjen "Anadoly-21"

Stërvitja e Forcave të Bashkuara Speciale "Anadoly-21" u zhvillua nën organizimin e Komandës së Forcave Speciale të Turqisë, me pjesëmarrjen e "Forcave Speciale" nga 7 vende. Në një deklaratë të Ministrisë turke të Mbrojtjes thuhet se Stërvitja e Forcave të Bashkuara Speciale "Anadoly-21", e cila filloi më 28 qershor ishte me pjesëmarrjen "de facto" të elementëve të forcave speciale të Turqisë, Shqipërisë, Azerbajxhanit, Katarit, Kazakistanit, Pakistanit dhe Uzbekistanit, dhe me pjesëmarrjen si vëzhgues të Kosovës dhe Mongolisë. Stërvitja u zhvillua nën organizimin e Komandës së Forcave Speciale të Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, në Ankara me qëllimin për të zhvil-



luar miqësinë, bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet elementëve të Forcave Speciale, për të ndarë infor-

macionin dhe përvojën reciproke si dhe zhvillimin e aftësisë për të kryer operacione së bashku.

Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore ka mbyllur më 23 korrik 2021, Kursin Bazë dhe atë të Avancuar të Nënoficerit, në specialitetin Këmbësori. Në ceremoninë e organizuar mori pjesë komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Ekland Dauti si dhe stafi mësimdhënës së Qendrës Stërvitore. Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Ekland Dauti, i cili pasi theksoi rëndësinë e kursit të sapombyllur, ndër të tjera vlerësoi bashkëpunimin me Komandën dhe Shtabin e FT, si dhe koordinimin e shkëlqyer me Akademinë e Forcave të Armatosura për realizimin e një programi sa më cilësor stërvitjeje.

“Theksojmë me krenari se personeli i Qendrës Stërvitore, vazhdon t’i qëndrojnë besnik asaj që bashkarish kemi vendosur të zbatojmë, në të gjithë kurset që zhvillohen, vlerësim real sipas meritës së gjithsecilit. Në këtë kurs, i cili u zhvillua në kushtet e pandemisë COVID - 19 dhe temperaturave të

Përfundon Kursi Bazë dhe ai i Avancuar i Nënoficerit

Kursi Bazë dhe ai i Avancuar i Nënoficerit në Qendrën Stërvitore vazhdoi për një periudhë 8-javore dhe u ndoq nga rreth 29 kursantë



larta, ju treguat të gjitha vlerat që karakterizojnë një nënoficer. Me durim dhe përkushtim gjithçka arrihet.” - tha në fjalën e tij kolonel Dauti. Një falënderim të veçantë, ai përcolli edhe për stafin e instruktorëve për devotshmërinë dhe pro-

fesionalizmin e treguar. Ceremonia vazhdoi me ndarjen e certifikatave dhe u mbyll me një foto të përbashkët. Kursi Bazë dhe ai i Avancuar i Nënoficerit në Qendrën Stërvitore vazhdoi për një periudhë 8 - javore dhe u ndoq nga rreth 29 kursantë.

Batalioni i Xhenios i Komandës Mbështetëse

Prej disa ditësh specialistët e kompanisë së urave të Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse kanë vijuar punimet për ndërtimin e urës “bailey” në Njësinë Administrative Voskop të Bashkisë Korçë, të cilat kanë përfunduar me montimin e urës bailey me gjatësi 24m, seksion 1/2 dhe me peshëmbajtje deri në 40 ton. Ndërtimi i kësaj ure është i një rëndësie të veçantë nga pikëpamja sociale dhe ekonomike në shërbim të një komuniteti prej rreth 15.000 banorësh. Kjo urë lidh 4 fshatra: Voskop, Polen, Ravonik, Turan gjithashtu bën të mundur lidhjen e 4 shkollave 9-vjeçare si dhe 5 qendrave shëndetësore, duke iu mundësuar lehtësi në lëvizje këtij komuniteti. Për ndërtimin e kësaj ure janë angazhuar, 9 specialistë të Togës së Urave si dhe 2 mjete. Punimet vijuan me intensitet të lartë, duke bërë të mundur realizimin në një kohë tepër të shkurtër të kësaj ure kaq të rëndësishme për

Ndërtohet dy ura “bailey”: Voskop-Korcë dhe Lug i Zi-Tropojë



banorët e zonës. Por specialistët e kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse ishin në Njësinë Administrative Tropojë, ku më 22 korrik përfunduan punimet për ndërtimin e urës “bailey” me gjatësi 18 m, seksion 1/2 dhe me peshëmbajtje deri në 24 ton. Ndërtimi i kësaj ure i shërben një komuniteti prej rreth 60 familje.

Kjo urë lidh 2 njësi administrative: Tropojë e Vjetër dhe Bytyç. Ura bën të mundur gjithashtu lidhjen shkollës 9-vjeçare me qendrën shëndetësore, duke lehtësuar lëvizjen e komunitetit të zonës. Për ndërtimin e saj u angazhuan 8 specialistë të Togës së Urave dhe 2 mjete duke mundësuar këtë ndërtim kaq të domosdoshëm e të rëndësishëm për këta banorë.

Zv/ministrja e mbrojtjes flet nga Ksamili

Para përgjegjësisë penale ata që dëmtojnë natyrën

Eshtë në kompetencë e FA që të përcaktojë territorin ku është e pamundur përdorimi i helikopterit dhe ku mund të përdoren mjetet e tjera

Efektivët e Forcave të Armatosura dhe të gjithë strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes u angazhuan përkrah pushtetit vendor për shuarjen e vatrave të zjarreve në zona të ndryshme të vendit. Pas gati tetë orësh në betejë me flakët u arrit që të izolohej vatra në kodrat e Ksamilit. Operacioni u ndoq nga zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, e cila në përfundim inspektoi terrenin më 31 korrik dhe përgëzoi efektivët e DMR Gjirokastrë dhe forcat zjarrfikëse, për punën e palodhur.

“Një falënderim shkon, jo vetëm për forcat operationale, efektivët e Ksamilit, por për të gjithë efektivët e Shqipërisë, të cilët janë duke shuar vatra të tjera zjarri. Edhe një herë treguat që me punën dhe përkushtimin tuaj të arrijmë që të mos kemi pasoja”, u shpreh zëvendësministria e Mbrojtjes.

Ndërkaq ajo paralajmëroi të gjithë zjarrvënësit që, me qëllim ose jo, dëmtojnë natyrën. “Unë do të kisha një thirrje për të gjithë banorët e Ksamilit, pushuesit, të gjithë qytetarët që të jenë të kujdesshëm me veprimet e tyre dhe siguroj që kushdo që me veprimet e tij rrezikon të shkatërrojë natyrën e bukur që na ka falur Zoti do të vihet para përgjegjësisë penale. Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura të Shqipërisë, të gjitha strukturat e tjera përgjegjëse do të jenë në krye të detyrës për çdo situatë emergjente, që mund të na paraqitet, duke pasur parasysh se jemi në stinën e verës dhe temperaturat e larta janë në disfavorin tonë”, theksoi zëvendësministria e Mbrojtjes. Në një prononcim për mediat, sipas ATSH, zv/ministrja Bici theksoi se, zgjidhja e rasteve të zjarrit nuk janë gjithmonë helikopterët. “Ne i kemi përdorur kur ka qenë e nevojshme. Pas remontit që po kryhet, shumë helikoptri do të jetë në gjendje pune. Eshtë në kompetencë të FA që të përcaktojë territorin ku është e pamundur përdorimi i helikopterit dhe ku mund të përdoren mjetet e tjera”- tha Bici. Agjencia e Mbrojtjes Civile bën me dije se puna për normalizimin e situatës po vijon edhe në Karaburun, ku paraqitet rasti më i vështirë. Grupit të punës për shuarjen e flakëve u janë bashkuar edhe 85 forca të tjera, ndër të cilët 40 janë efektivë të FA. Po ashtu puna po vijon edhe në qarkun Fier, ku po punohet me mjete të tonazhit të rëndë. Vatra aktive mbeten në fshatin Mazhicë, bashkia Bulqizë, ku zjarri ka djegur sipërfaqe me shkurre dhe ferra, por edhe në fshatin Delvinë, bashkia Përmet. Puna po vijon për normalizimin e situatës edhe në fshatin Shikaj, bashkia Kukës, në fshatin Shetaj, bashkia Durrës, ku janë përfshirë nga flakët një sipërfaqe me shkurre, ullishte dhe pyll pishe.



Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi ka reaguar për për zjarret në Shqipëri. Ai informon më 31 korrik 2021, se në këtë datë ishin 8 vatra aktive. Situata më kritike sipas tij ndodhet në Karaburun, Shijak, Përmet e Fier. "Aktualisht në vend kemi 8 vatra zjarri aktive, të gjitha strukturat shtetërore të emergjencave civile në zonat përkatëse, po punojnë intensivisht për neutralizimin e tyre. Në zonat ku situata paraqitet më kritike, janë angazhuar mjetet dhe trupat e Forcave të Armatosura, të tilla janë rastet e Karaburunit, Shijakut, Përmetit, Fierit etj. Pjesa tjetër e Forcave të Armatosura është në gatishmëri të plotë për situata të mundshme në orët/ditët në vazhdim.

Nga ana tjetër i bej thirrje komunitetit të jetë i kujdesshëm në zonat ku për shkak të thatësisë paraqitet rrezik i lartë zjarri,

Bashkëpunim me strukturat për evidentimin e keqbërësve

Forcat e Armatosura janë në gatishmëri të plotë për të përballuar situatat e krijuara nga rënia e zjarreve



gjithashtu i ftoj ata të bashkëpunojnë me strukturat shtetërore për njoftimin në kohë të situatave apo denoncimin/evidentimin e keqbërësve të qëllimshëm", shkruan ministri në facebook.

26 orë fluturimi mbi Tomorr

Në këto ditë të nxehta të motit, helikopteri Cougar dhe ekujpazhi i tij me pilotë e teknikë në bord, prej pesë ditësh kanë kryer operacione për shuarjen e zjarreve në malin e Tomorrit.

Ndërhyrja nga ajri e helikopterit Cougar, i pajisur me kovën e posaçme "Bambi Bucket" për shuarjen e zjarrit, ka bërë të mundur mbajtjen nën kontroll, neutralizimin e shuarjen e disa vatrave të zjarrit në këtë zonë, duke realizuar kështu rreth 26 orë fluturimi dhe në kushtet shpesh herë të pamjes së kufizuar për shkak të terrenit të mbuluar nga tymi dhe flakët.

Gjatë këtyre ditëve, pilotët dhe teknikët e helikopterit Cougar kanë punuar ditën e natën me përkushtim për kryerjen me sukses të këtij operacioni.

Helikopteri "Cougar" në shuarjen e zjarreve në malin e Tomorrit



Forca Ajrore me strukturat e saj kryesisht Baza Ajrore Farkë do vijojnë të jenë në gatishmëri për

t'u përgjigjur emergjencave në të gjitha rastet kur do kërkohet ndërhyrja e tyre.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) e vullnetarë të tjerë, Batalioni i Mbështetjes Rajonale (BMR) të Komandës Mbështetëse (KM), ka marrë, një operacion të veçantë, atë të pastrimit të bregut të liqenit të Kukësit nga mbetjet plastike dhe ato inerte. Në ceremoninë e hapjes për këtë qëllim ishin të pranishëm Ministri i Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi, zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, shefi i Operacioneve të KM kolonel Ernest Premçe, ndërsa nga pala kosovare ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm i FSK-së dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë Minxhozi.

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj theksoi se me këtë aksion, dëshmojmë se vullneti ynë është vullnet për të pastrën, të bukurën, të natyrshmen që i duhet jo vetëm popullit tonë në dy shtetet, por të gjithë popujve dhe të gjithë njerëzimit. Gjithashtu, ai tha se “ushtria përveç se është gjithmonë e gatshme të përballët me kërcënime dhe rreziqe të karakterit ushtarak, ajo është e gatshme dhe çdo çast në veprim për të parandaluar dhe evituar fatkeqësitë dhe katastrofat natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri”. Aksioni u realizua me sukses dhe nga të gjithë pjesëmarrësit u vlerësua se duhet që programe të ngjashme të organizohen edhe në të ardhmen.

Nëpërmjet këtij operacioni u realizua pastrimi i një vije prej 7 km, të bregut të liqenit të Kukësit, pranë vijës kufitare Shqipëri-Kosovë nga papastërtitë e mbetjet inerte, duke i shërbyer vendit e turizmit. Nga KM u angazhuan 2 varka, 4 mjete dhe 47 forca të BMR dhe DMR Kukës.

Kryeministri Rama e ka përshëndetur nismën “Lundro dhe Pastro” si një nismë që u vendos ‘në jetë’, nga autoritetet shqiptare dhe ato në Kosovë. Kryeministri Rama, nëpërmjet një statusi në rrjete sociale, shkruan se Kosova dhe Shqipëria janë një komb, një destinacion dhe

Nisma “Lundro dhe Pastro” për një mjedis të pastër në Liqenin e Kukësit

U realizua pastrimi i një vije prej 7 km në bregun e liqenit të Kukësit, duke i shërbyer vendit e turizmit. Nga KM u angazhuan 2 varka, 4 mjete dhe 47 forca të BMR dhe DMR Kukës



kanë një qëllim: Për të pasur një mjedis e turizëm të përbashkët në të dyja anët e Bjeshkëve. Kjo nismë konsiston në mbajtjen pastër të mjedisit, për t'i ofruar kështu turistëve dhe pushuesve një pamje më të plotë e të pastër të bukurive të të dyja vendeve. “Jena 1. Një komb, një

destinacion, një ofertë turistike dhe një mjedis i pastër. Forcat e ushtrisë së Shqipërisë e Kosovës së bashku me vullnetarë, në një ditë pastrimi të tokës e ujërave të përbashkët, për të vijuar me bashkëpunime të tjera në mjedis e turizëm në të dyja anët e Bjeshkëve”, -shkruan kryeministri.

Vendimi i Këshillit të Ministrave

Përcaktimi i specialiteteve në Forcat e Armatosura

Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e ardhur nga Ministria e Mbrojtjes lidhur me specialitetet në Forcat e Armatosura. Kështu Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin “Per përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Vendimi i mesipërm është mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 21, të ligjit nr.59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Kështu Këshilli i Ministrave vendosi përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij vendimi. Kurse ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Në këtë sezon veror, Forca Ajrore ka ndërmarrë iniciativën "Në ndihmë të fëmijëve jetimë", e finalizuar me një ceremoni dorëzimi, tek Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Tiranë, të kontributeve të personelit ushtarak dhe civil të strukturave të Forcës Ajrore, të cilët, me vullnet të lirë sipas dëshirës dhe mundësive, dhuruan ndihma të dedikuara për fëmijët jetimë që jetojnë në komunitet, kryesisht kontribute ushqimore, por edhe veshmbathje.

Në këtë aktivitet, të zhvilluar më 12 korrik 2021, ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, shefi i shtabit kolonel Arben Cenolli, koordinatori e programit social e Kryqit të Kuq shqiptar znj. Anila Koxha, përfaqësues të shtabit, komandës e strukturave të Forcës Ajrore kontribuuese në këtë iniciativë si dhe një grup vullnetarësh të Kryqit të Kuq.

Me një reagim pozitiv dhe një rrjet të menjëhershëm bashkëpunues, personeli i komandës, shtabit, kompanisë së mbështetjes së shtabit, qendrës së kontroll-raportimit, Bazës Ajrore Farkë dhe Kuçovë, Shërbimit Meteorologjik Ushtarak u sensibilizuan, duke u bërë pjesë e kësaj iniciative dhe duke përçuar jo vetëm mesazhin e mirësisë dhe ndihmës për fëmijët jetimë në komunitet të cilët kanë nevojë për mbështetje, por edhe simbolikën që së bashku, ne kujdesemi dhe kontribuojmë për komunitetin.

Në fjalën e tij të përshëndetjes, kolonel Ylli Pulaj falënderoi Kryqin e Kuq shqiptar, Dega Tiranë, për mundësinë e pjesëmarrjes në këtë iniciativë sa humane por edhe domethënëse për bërjen bashkë të komunitetit tonë të ushtarakëve dhe civilëve në Forcën Ajrore në kontributin për fëmijët jetimë që jetojnë në komunitetin që na rrethon, gjest ky, nëpërmjet të cilit përcjellim mesazhin se ata nuk janë vetëm.

Më tej, kolonel Pulaj shtoi se: "Bashkimi në këtë iniciativë i personelit të Forcës Ajrore është një tregues i ndjeshmërisë, humanizmit, vazhdimësisë së përfshirjes së ushtarakëve dhe civilëve, por edhe fëmijëve të tyre duke kontribuar në data apo sezone të veçanta të

Forca Ajrore i bashkohet iniciativës "Në ndihmë të fëmijëve jetimë"

Kolonel Pulaj: "Bashkimi në këtë iniciativë i personelit të Forcës Ajrore është një tregues i ndjeshmërisë dhe humanizmit në ndihmë të fëmijëve jetimë por edhe njerëzve në nevojë"



vitit në ndihmë të fëmijëve jetimë por edhe njerëzve në nevojë". Më pas znj. Koxha përcolli falënderimet e saj dhe të sekretares së Kryqit të Kuq shqiptar, Dega Tiranë, për personelin e Forcës Ajrore duke e konsideruar këtë kontribut për fëmijët jetimë, tashmë traditë jo vetëm të Forcës Ajrore por edhe të Forcës së Armatosur. Aktiviteti u mbyll me firmosjen e marrjes dhe dorëzimit të kontributeve të Forcës Ajrore të adresuara për Kryqin e Kuq shqiptar, Dega Tiranë, të dedikuara për fëmijët jetimë që jetojnë në komunitet, por dhe me një foto të përbashkët të pjesëmarrësve në ceremoni.

Shoqata e Ushtarakëve Rezervë vizitë te ushtarakët kosovarë

Në kuadër të vizitës në Kosovë dhe aktiviteteve me shoqatën homologe kosovare, delegacioni i nivelit më të lartë, i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes ku u pritën nga zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Syla. Me këtë rast, kolonel Thoma Konduri, i shoqëruar nga major Hamit Gojani dhe major Kujtim Boriçi si dhe kryesuesi i shoqatës së oficerëve rezervë të Kosovës, CIOR Kosova, nënkolonel Prindon Sadriu, dhe kolegu kapiten Gezim Kunoviku, shprehu përshtypjet e tij për pritjen vëllazërore duke njoftuar në vazhdim me fushëveprimin, aktivitetet e organizatës dhe qëllimin e vizitës në funksion të thellimit të bashkëpunimit dhe koordinimit me kolegët e Kosovës për të ardhmen. Nga ana e tij, zv. ministri Syla falënderoi për vizitën duke përgëzuar për iniciativën shumë domethënëse dhe me interes në diplomacinë tonë të mbrojtjes, duke pasur parasysh statusin e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë si anëtare e Konfederatës Ndërlidhëse të Oficerëve Rezervë (Interallied Confederation of Reserve Officers- CIOR), asociacion ky i shoqatave të oficerëve rezervë në NATO dhe më gjerë, ku aspiron edhe shoqata e oficerëve rezervë të Kosovës, CIOR Kosova. Në fund, nënkolonel Sadriu njoftoi me aktivitetet e CIOR Kosova, dhe bashkëpunimin me shoqatën homologe të Shqipërisë, që pritet të kurorëzohet së shpejti me zyrtarizmin e marrëveshjes bilaterale. Ai gjithashtu, njoftoi se CIOR Kosova angazhohet për afirmimin e ushtarakut rezervë të Kosovës edhe në rrafshin ndërkombëtar shumë të nevojshëm në këtë periudhë të zhvillimeve të përgjithshme.



Forcat e Armatosura: Kampionati i Futbollit për vitin 2021

Forca Tokësore fiton Kampionatin e Futbollit në rang FA

Në mjediset e Garnizonit "Skënderbej", në Ministrinë e Mbrojtjes, u ceremonia e mbylljes së Kampionatit të Futbollit për Forcat e Armatosura për vitin 2021, ku morën pjesë tetë ekipe, përfaqësuese të komandave të forcave kryesore dhe reparteve autonome (FT, FD, FAj, KM, PU, AFA, ASNI, BMbSHPFA). Kampionati i futbollit është një aktivitet sportiv i përvitshëm, i cili përveç rëndësisë që ka në përgatitjen fizike të trupave, përcjell dhe mesazhin "Miqësi nëpërmjet Sportit" (Friendship through Sport). Në këtë kampionat ekipet u ndanë në dy grupe dhe ekipet e renditura në vendet e para dhe të dyta u kualifikuan në fazën finale. Finalja e kompeticionit, e cila u ndoq nga afër nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, si dhe drejtorë drejtorish në SHP, u

luaft ndërmjet Policisë Ushtarake dhe Forcës Tokësore, ku Forca Tokësore fitoi me meritë me rezultatin 1-0 dhe u shpall "Kampion" i Kampionatit të Futbollit në FA-së, për vitin 2021.

Në përshëndetjen e saj drejtuar pjesëmarrësve në këtë aktivitet sportiv, gjeneralmajor Shehu vuri theksin se këto aktivitete i shërbejnë rritjes së frymës së kolektivitetit dhe shpirtit të garës, tipare këto që karakterizojnë Forcat e Armatosura, për arritjen e synimeve dhe objektivave për realizimin e detyrave. Më tej, zëvendësshefi i SHP të FA-së përshëndeti në veçanti fituesit e këtij kompeticioni, por edhe sportistët e përzgjedhur për krijimin e ekipit përfaqësues në FA, në kompeticionet e ardhshme brenda dhe jashtë vendit. "Ky aktivitet tregon më së miri se sporti i shërben forcimit të miqësisë midis ushtarakëve, rritjes së ndjenjës së bashkëpunimit dhe respektit ndaj njëri – tjetrit, por edhe më gjerë. Futbolli është lojë që harmonizon

më së miri përfitimin e cilësive të forcës, rezistencës shpejtësisë si dhe aftësive që ushtaraku duhet të zotërojë për përballimin e stresit mendor dhe emocional në stërvitje, detyrë, operacion", u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Shehu.

Vendin e parë në kampionatin e futbollit të FARSH për vitin 2021 e fitoi ekipi i komandës së Forcës Tokësore, ndërsa vendin e dytë e zuri Policia Ushtarake si dhe dy vendet e treta Forca Detare dhe Komanda Mbështetëse. Ndeshjet në grup: Ndeshja e parë Forca Tokësore-Forca Detare 1:1. Ndeshja e dytë Forca Tokësore-Forca Ajrore 5:0. Ndeshja e tretë Forca Tokësore-Policia Ushtarake 1:0. Gjysmë finale: Forca Tokësore-Forca Detare 3:0. Finale Forca Tokësore-Policia Ushtarake 1:0. Në këtë aktivitet sportiv u shpërndanë certifikata dhe medalje për arbitrat dhe asistentët që drejtuan ndeshjet e futbollit midis ekipeve pjesëmarrëse, si dhe medalje për lojtarët dhe ekipet fituese pjesëmarrës në këtë kampionat.

Në mjediset e Batalionit të Policisë Ushtarake në Rinas, u zhvillua Kampionati i Ping-pongut të Forcave të Armatosura për vitin 2021, ku morën pjesë tetë ekipe, përfaqësuese të komandave të forcave kryesore dhe reparteve autonome FT, FD, FAj, KM, PU, AFA, ASNI, BMbSHPFA. Në këtë kampionat ekipet u ndanë në dy grupe dhe ekipet e renditura në vendet e para dhe të dyta u kualifikuan në fazën finale. Finalja e kompeticionit, u ndoq nga afër nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e shoqëruar nga presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, z. Fidel Ylli dhe sekretarja e Federatës së Qitjes, znj. Eda Çausi. Pasi falënderoi të gjithë të pranishmit në këtë aktivitet sportiv, gjeneralmajor Shehu u shpreh se këto aktivitete sportive janë pjesë e aktivitetit normal të FARSH, por njëkohësisht edhe një komponent organik i përgatitjes profesionale ushtarake. "Unë besoj se është domethënëse që ky aktivitet vjen pas stërvitjes së madhe "Defender 21", që FA e kurorëzuan me sukses në kuadrin e NATO, kampionatit të futbollit, suksesteve në disa gara ushtarake rajo-

FA: Zhvillohet kampionati i pingpongut për vitin 2021



nale dhe shumë aktivitete të tjera. Stërvitja dhe aktivitetet e tjera ushtarake reflektuan dhe demonstruan aftësitë profesionale të ushtarakëve të FA, midis së cilave edhe kondicionin e duhur fizik, duke përballuar me sukses intensitetin dhe kohëzgjatjen e stërvitjeve, apo të aktiviteteve të tjera me kërkesa të larta të përgatitjes fiziko-ushtarake...", - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Shehu në përshëndetjen e saj.

Gjithashtu, gjeneralmajor Shehu adresoi një falënderim të veçantë për presidentin e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe sekretaren

e Federatës së Qitjes, të cilët me praninë e tyre në këtë aktivitet sportiv të Forcave të Armatosura tregojnë më së miri mbështetjen, vëmendjen dhe inkurajimin ndaj FA në aktivitetet sportive. Në përfundim të përshëndetjes së saj, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në këtë garë, komandantët dhe drejtuesit e strukturave të tyre, si dhe organizatorët e këtij kampionati, për seriozitetin dhe përkushtimin e treguar duke përmbushur me sukses këtë aktivitet.

Në Garnizonin Rinas

Në Garnizonin Rinas u zhvillua me 1 korrik 2021, ceremonia me rastin e 90-Vjetorit të Krijimit të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore. Në aktivitetet ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, drejtues të strukturave të vartësisë të Forcës Ajrore, ish-komandanti i Mbrojtjes Kundërajrore, gjeneral brigade në rezervë Ylli Dimraj, veteranë të kësaj arme në vite si dhe pjesëtarë të Forcës Ajrore.

Në fjalën e hapjes, kolonel Ylli Pulaj pasi i uroi mirëseardhjen të ftuarve përshkroi rrugëtimin e Armës Kundërajrore në vite duke evidentuar edhe disa momente të rëndësishme historike.

Në vijim, kolonel Pulaj shprehu mirënjohjen për familjarët e dëshmorëve të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore të rënë në krye të detyrës duke i përkujtuar ata me respekt e nderim. Kolonel Pulaj theksoi gjithashtu, kontributin e veçantë të Mbrojtjes Kundërajrore gjatë luftës në Kosovë, duke realizuar vrojtimin e pandërprerë të hapësirës ajrore dhe krijimin e lehtësirave aeroportuale për realizimin e operacioneve ajrore të NATO në Kosovë.

Në përfundim të fjalës së tij,

zëvendëskomandanti, kolonel Ylli Pulaj përmendi kontributin aktual të Forcës Ajrore me personel në strukturat ajrore operacionale dhe taktike të NATO-s, si dhe projektet për asetet moderne të vëzhgimit ajror dhe kompletimit me elementë të mbrojtjes ajrore të bazuara në tokë, në vitet në vazhdim.

Në emër të shoqatës së Mbrojtjes Kundërajrore përshëndeti gjeneral brigade Ylli Dimraj. Në fund të ceremonisë, u shpërndanë medaljet e karrierës për personelin e Forcës Ajrore sipas ligjit.



MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg udhëtoi më 01 korrik 2021, drejt Forcës së Kosovës të udhëhequr nga NATO, (KFOR), ku u takua me Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici, me personelin nga 27 kombe kontribuese me trupa (përfshirë aleatët dhe partnerët e NATO-s), si dhe me drejtorin e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s gjenerabrigade Jörg Ruter.

"Fakti që ne jemi kaq shumë kombe këtu nga vendet aleate të NATO-s, por edhe nga disa kombe partnere tregon forcën e misionit tonë. Kjo demonstroi përkushtimin e shumë kombeve për stabilitetin dhe paqen në Kosovë dhe në këtë rajon", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. "Misioni i KFOR-it është i rëndësishëm jo vetëm për Kosovën dhe rajonin, por edhe për NATO-n dhe për të gjithë aleatët e NATO-s", theksoi Sekretari i Përgjithshëm. "Për shumë vite operacioni në Afganistan ishte më i madhi, por ndërsa flasim së shpejti do t'i japim fund këtij misioni. KFOR jo vetëm që do të jetë operacioni më i gjatë, por edhe më i madh ushtarak i NATO-s", tha ai gjithashtu.

Gjatë vizitës së tij, Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg zhvilloi takime bilaterale me Presidenten e Kosovës Vjosa Osmani, Kryeministrin Albin Kurti dhe politikanin serb Goran Rakić. Ai riktheu përpjekjet e vazhdueshme të KFOR-it për të mirën e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe mbështetjen e palëkundur të NATO-s për Dialogun e lehtësuar nga BE dhe përpjekjet e tjera që synojnë normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës.

JENS STOLTENBERG VIZITË NË KOSOVË

Riafirmohet angazhimi i NATO-s për misionin e KFOR-it



Fqinjësia e qëndrueshme jep siguri

"Është shumë mirë për mua të kthehem në Prishtinë përsëri, në Kosovë, dhe të mund të takoj përsëri KFOR-in dhe trupat nga kombet e ndryshme që marrin pjesë në misionin tonë shumë të rëndësishëm këtu", tha në fjalën e tij për trupat e KFOR-it, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, dhe duke uruar në fillim Kanadanë për Ditën e tyre Kombëtare, ai tha se vetëm "fakti që ne jemi kaq shumë kombe këtu nga vendet aleate të NATO-s, por edhe nga disa kombe partnere, tregon fuqinë e misionit tonë. Kjo demonstroi përkushtimin e shumë kombeve për stabilitetin, paqen në Kosovë dhe në këtë rajon dhe duhet ta dini se misioni i KFOR-it është i rëndësishëm jo vetëm për Kosovën, për rajonin, por është gjithashtu i rëndësishëm për NATO-n dhe për të gjithë aleatët e NATO-s, sepse kemi parë gjatë gjithë historisë, se stabiliteti në këtë rajon ka rëndësi për të gjithë ne. Ka rëndësi për Evropën, ka rëndësi për NATO-n.

Kështu, siç themi shpesh në NATO, kur fqinjësia jonë është më e qëndrueshme ne jemi më të sigurt dhe ju po na ndihmoni ta arrijmë atë. Mesazhi im kryesor sot është të falënderoj të gjithë burrat dhe gratë që shërbejnë në KFOR. Të gjithë burrat dhe gratë që e kanë bërë të mundur këtë. Dhe gjithashtu e dini që ju nuk keni qenë vetëm duke u marrë me situatën e sigurisë, sfidat politike në këtë rajon në Kosovë, por gjithashtu keni qenë në një situatë ku keni pasur nevojë të merreni edhe me pandeminë, dhe përballeni me

Covid-19 dhe kjo është gjithmonë e vështirë, por natyrisht është veçanërisht sfiduese në një operacion ushtarak, mision, si KFOR. Kështu që unë e di që ju keni qenë në gjendje të trajtoni pandeminë në një mënyrë profesionale dhe të përmbani një numër të kufizuar të njerëzve të infektuar, dhe unë ju përgëzoj gjithashtu për mënyrën se si keni qenë në gjendje të përballeni me pandeminë ndërsa kryeni edhe punën tuaj të rëndësishme në misionin i KFOR-it.", tha Stoltenberg.

"Më lejon të them gjithashtu se KFOR është siç e dini të gjithë operacionin ushtarak më i gjatë në NATO. Sigurisht që kemi aktivitete të ndryshme ushtarake, kemi aktivitete të NATO-s brenda territorit të NATO-s dhe natyrisht që e patëm atë për më shumë se 70 vjet, për sa kohë që NATO ka ekzistuar. Por kur shohim misionet ushtarake dhe operacionet jashtë NATO-s, nuk ka asnjë mision apo operacion tjetër që të ketë zgjatur më shumë se KFOR-i", theksoi Sekretari i Përgjithshëm. "Për shumë, shumë vite sigurisht që operacioni në Afganistan ishte më i madhi, por ndërsa flasim së shpejti do ta përfundojmë atë mision. KFOR-i jo vetëm që do të jetë operacioni më i gjatë, por edhe më i madh ushtarak i NATO-s. Pra, edhe një herë, faleminderit për atë që bëni. Ne jemi jashtëzakonisht mirënjohës. Faleminderit për shërbimin tuaj. Është e rëndësishme për të gjithë ne që ju e bëni atë në mënyrën tuaj, me përkushtim, me profesionalizëm dhe me përkushtimin që të gjithë ju tregoni dhe demonstroi çdo ditë".



FSK duhet të marrë leje nga KFOR për të kaluar në veriun e Kosovës

Gjatë takimeve që pati Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin, Albin Kurti, deklaroi se autoritetet kosovare duhet të respektojnë marrëveshjen ndërmjet NATO-s dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), që FSK të mos hyjë në pjesën veriore të Kosovës pa marrëveshje me KFOR-in, raportuan mediet në vend. "Kjo është diskutuar dhe e mirëpres që autoritet e Kosovës vazhdojnë të mbështetësin marrëveshjen e vitit 2018, që FSK të mos kalojë në pjesën veriore pa marrëveshjen e KFOR-it. Kjo reflekton sensitivitetin e situatës dhe është mënyra më e mirë për të gjetur një balancë. Ne vazhdojmë të mbështesim zgjidhjen e një marrëveshjeje politike në kuadër të dialogut Prishtinë-Beograd", tha Stoltenberg.

Nga ana tjetër Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti këtë marrëveshje të rikonfirmuar në vitin 2018 ndërmjet NATO-s dhe ish presidentit Hashim Thaçi, e sheh të dëmshme për Kosovën dhe si të tillë një muaj më parë ai e ka dërguar atë në prokurori. Sipas kryeministrit kosovar Kurti kjo përbën shkelje të Kushtetutës. Në një letër-këmbim të vitit 2013, Hashim Thaçi e ka siguruar ish Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Anders Fog Rasmussen se FSK-ja "do të ndërmerre mision në veri të Kosovës vetëm me pajtimin paraprak të KFOR-it", dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se kjo marrëveshje është akoma e vlefshme. "Kjo vlen akoma dhe pasqyron gjithashtu ndjeshmëritë dhe sfidat. Mendoj se është mënyra më e mirë për të vazhduar gjetjen e balancës së duhur dhe shmangien e çdo situatë që mund t'i minojë dhe dobësojë përpjekjet për të gjetur një zgjidhje

politike dhe të çdo gjëje që mund të minojë dialogun Prishtinë-Beograd", tha Jens Stoltenberg, duke shtuar se "kur nënshkruani një marrëveshje, ajo vazhdon edhe kur keni persona të rinj në pozita përgjegjëse", tha Stoltenberg duke komentuar vendimin e kryeministrit Kurti për ta dërguar marrëveshjen në prokurori.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, po ashtu tha se NATO do të vazhdojë ta mbështesë Forcën e Sigurisë së Kosovës, por brenda mandatit të saj fillestar, pra para vendimit të Kuvendit të Kosovës që me anë të ligjit FSK-në e shndërroi në ushtri të Kosovës, por pa ju ndërruar emri. "Kur është marrë vendimi, unë kam thënë se ka qenë i gabuar. NATO do të vazhdojë të punojë me FSK-në brenda mandatit të saj origjinal. Kjo është ajo që ne e mbështesim", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, cituan mediet. Por Kosova nga ana e saj është e përkushtuar për anëtarësim në NATO, dhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pas takimit me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, shkroi se "NATO, ka rol vendimtar në lirinë e Kosovës, por edhe për kontributin e tashëm për një ambient të qetë e të sigurt, nëpërmjet trupave të KFOR-it". Ajo tha se KFOR-i po vazhdon trajnimin e FSK-së, e cila procesin e tranzicionit në ushtri, dhe sipas saj, po e kryen konform standardeve të NATO-s, duke qenë e denjë për t'u bërë pjesë e Organizatës së Atlantikut të Veriut. "Ne po punojmë me përkushtim që të anëtarësohemi në NATO. Kemi nevojë për mbështetjen e kësaj organizate edhe me anëtarët e NATO-s, të cilët nuk e njohin Kosovën", tha presidentja Osmani. Por edhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg gjithashtu, duke folur për kërkesën e vazhdueshme të Prishtinës zyrtare për anëtarësim e Kosovës në NATO, tha se "anëtarësimi në NATO bazohet në konsensus. Ne kemi nevojë që të gjithë aleatët të bien dakord", tha ai. "Prandaj, mënyra e vetme për të arritur anëtarësimin për këdo, është që të gjithë aleatët të bien dakord". Stoltenberg tha se gjëja më e rëndësishme që Kosova mund të bëjë tani, është të vazhdojë të angazhohet për dialogun me Serbinë.

KFOR, forcë paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO

KFOR është forca paqeruajtëse ndërkombëtare e drejtuar nga NATO në Kosovë, ku operacionet e saj gradualisht po zvogëlohen derisa Forca e Sigurisë së Kosovës, e themeluar në 2009, "të bëhet e mjaftueshme

për veten". KFOR hyri në Kosovë në 11 qershor 1999, pikërisht dy ditë pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB, kur Kosova po përballlej me një krizë të rëndë humanitare dhe jo vetëm. Gati një milion njerëz ishin larguar nga Kosova si refugjatë, shumë prej të cilëve nuk u kthyen përgjithmonë. KFOR gradualisht po transferon përgjegjësitë tek Policia e Kosovës dhe autoritetet e tjera lokale. KFOR përqendrohet në ndërtimin e një ambienti të sigurt dhe garantimin e lirisë së lëvizjes në të gjithë territorin e Kosovës për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga origjina e tyre etnike, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB, si dhe lehtësimi i integritetit Euro-Atlantik i Ballkanit Perëndimor. Vendet e Grupit të Kontaktit kanë thënë publikisht se KFOR do të mbetet në Kosovë për të siguruar sigurinë e nevojshme për të mbështetur zgjidhjen përfundimtare të autoriteteve të Kosovës.

Mjedisi operational në Kosovë ka ndryshuar ndjeshëm në 20 vitet e fundit dhe do të vazhdojë të ndryshojë edhe në të ardhmen. KFOR në mënyrë konstante ka përshtatur rolin dhe strukturën e tij me qëllim përballjen me sfidat në mënyrë sa më efektive në interes të sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë. Ndryshimi i fundit në strukturë organizative të KFOR është ai i gushtit të vitit 2019, në të cilën kemi Grupin e Mbështetjes të Shtabit(HSG) dhe Grupin e Përbashkët të Mbështetjes Logjistike(JLSG) në Camp Film City, dy komandat rajonale, atë lindore dhe perëndimore, respektivisht RCE-E në kamp Bondsteeldhe RCW në CampVillaggio Italian me seli në CampVillaggio Italia, Njësia e Specializuar Shumëkombëshe (MSU), në Prishtinë, Batalioni i Rezervës Taktike të KFOR-it (KTRBN), në Kampin NovoSelo. Në kulmin e tij, trupat e KFOR-it përbëheshin nga 50,000 burra dhe gra nga 39 vende të ndryshme të NATO-s dhe ato partnere nën komandë dhe kontroll të unifikuar. KFOR po bën gradualisht transferimin e përgjegjësiave policisë së Kosovës dhe autoriteteve të tjera lokale. Aktualisht, 27 shtete kontribuojnë në KFOR, me një forcë të kombinuar prej më shumë se 3,500 të personelit ushtarak dhe civil.

Lidhur me stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, roli i NATO-s ka një rëndësi të madhe jo vetëm për anëtarësimin në Aleancë të vendeve të rajonit si e Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, së fundmi, apo aspiratat e Kosovës në të ardhmen, por edhe për sfidat e rajonit dhe ndikimet e huaja.

Gjenerali amerikan Wesley Clark rikthehet në Kosovë

Qendra e Studimeve Universitare e Akademisë së Mbrojtjes do të emërohet “Qendra e Studimeve Universitare-Wesley Clark”

Me ftesë zyrtare të Ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj, ditën e mërkurë më 7 korrik 2021, ka zhvilluar një vizitë në Kosovë, Gjenerali historik amerikan, Wesley Clark. Gjeneralin amerikan Wesley Clark e priti ministri Mehaj i shoqëruar nga komandanti i FSK-së dhe stafi më i lartë i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Vizitës i ka paraprirë takimi virtual i datës 25 qershor kur gjeneral Clark shprehu vullnetin e tij për ofrimin e këshillave nga eksperiencia e tij profesionale ushtarake dhe akademike në rast nevojë për ministrin Mehaj.

Pritja me nderimet më të larta ushtarake, pasuan me takimin tetë-a-tetë të ministrit Mehaj dhe gjeneral Clark dhe takimin në nivel të delegacioneve më të larta. Pas takimit, të dy iu adresuan mediave të shumta me mesazhet për qëllimin dhe përmbajtjen e diskutimeve. Me këtë rast, ministri Mehaj shprehu nderin e madh për të dhe Ministrinë e Mbrojtjes si dhe rëndësinë historike që ka vizita e gjeneral Clark. Duke theksuar se, gjeneralin Clark e njoftoi me të arriturat e deritashme të FSK-së, procesin e tranzicionit si dhe qëllimet dhe objektivat e tij për të ardhmen. Ai gjithashtu, njoftoi se në shenjë të mirënjohjes dhe falënderimit të përhershëm për kryeveprën e tij-Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës dhe vizitës historike në Ministrinë e Mbrojtjes, nga sot Qendra e Studimeve Universitare e Akademisë së Mbrojtjes do të emërohet “Qendra e Studimeve Universitare-Wesley Clark”.

Nga ana e tij, gjeneral Clark theksoi se është shumë i lumtur që rikthehet në Kosovë. “Përgjatë viteve



kam parë progres në Kosovës. Është një marsh mbresëlënës drejt demokracisë dhe lirisë. Shpresoj edhe për rritjen e zhvillimit ekonomik për popullin e Kosovës. Populli i Kosovës i dërgon një shembull të fortë Botës se çfarë është vendosmëria që të jetojnë dhe t'i shërbejnë demokracisë dhe çfarë do të thotë të japësh për vendin tënd”, tha Gjenerali Clark. Në vazhdim, gjeneral Clark vizitoi edhe Qendrën Universitare ku nga ministri Mehaj iu komunikua zyrtarisht dhe iu dorëzua vendimi për emërimin e QSU-së me emrin e tij “Qendra e Studimeve Universitare-Wesley Clark”. Nga QSU, gjeneral Clark vazhdoi vizitën në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, ku u prit nga Shefi i Shtabit, gjeneral brigade Jeton Dreshaj me bashkëpunëtorë të cilët e njoftuan atë me sistemin organizativ dhe operacional të FSK-së.

Më pas, gjeneral Clark i shoqëruar nga Ministri Mehaj, vazhdoi takimet me Presidenten Vjosa Osmani, Kryeministrin Albin Kurti, Kryediplomatën Donika Gërvalla dhe Kryeparlamentarin Konjufca. Në takimin me Presidenten Vjosa Osmani,

ai tha se: “Ky vend është krijuar falë shpirtit tuaj kryengritës dhe këmbënguljes së qytetarëve të këtij vendi për ta fituar lirinë”. Kurse në takimin me kryeministrin Albin Kurti, gjenerali Clark, shprehu mbështetje për synimet e qeverisë për zhvillim ekonomik dhe prosperitet mbarëshoqëror. Shteti i Kosovës është miku më i madh i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Evropë, shtoi gjenerali Clark, teksa rikujtoi herën kur presidenti Bill Clinton, pas vizitës së tij të fundit në Kosovë, i kishte thënë se Kosova është gjëja më e mirë që e ka bërë gjatë presidencës së tij tetë vjeçare. Më tej, ai tha se Kosova është histori suksesi për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si asnjë tjetër.

Gjeneral Wesley Clark, më 1999 ishte prijës i operacionit ajror 78 ditësh me bombardimet e caqeve serbe, si Komandant Suprem i Forcave të NATO-s, operacion ky që rezultoi me kapitullimin e forcave ushtarake të Serbisë dhe arritjen e paqes bashkë me lirinë e popullit të Kosovës.



Ministri Armend Mehaj priti homologun hungarez Tibor Benko

Hungaria do të marrë së afërmi drejtimin e KFOR-it në Kosovë

Në kuadër të takimeve me homologët e vendeve partnere, ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj priti me 8 korrik 2021, në takim, ministrinë e Mbrojtjes së Hungarisë, z. Tibor Benko. Me këtë rast, ministri Mehaj shprehu mirënjohjen për kontributin e Hungarisë si vend anëtarë i NATO-s me trupat ushtarake në kuadër të misionit të KFOR-it në Kosovë e në një të ardhme të afërt edhe me komandantin e radhës së KFOR-it nga Hungaria duke siguruar për bashkëpunim të ngushtë me të nga pozitat respektive. Ai gjithashtu, shprehu interesimin për intensifikimin e bashkëpun-



imit bilateral në fushat e interesit të përbashkët në funksion të sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Nga ana e tij, ministri Benko, e uroi detyrën e ministrit të mbrojtjes

duke vlerësuar bashkëpunimin e deritashëm si shumë të mirë dhe shprehu gatishmërinë që ky bashkëpunim të thellohet edhe më shumë në të ardhmen.

BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET USHTARAKE AMERIKANE

Ministri Mehaj vlerëson gjeneralin amerikan Larry L. Henry

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj priti në takimin lamtumirës gjeneralin amerikan Larry L. Henry, i cili përfundoi shërbimin njëvjeçar në detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të KFOR-it. Me këtë rast, me protokoll ceremonial, ministri Mehaj dekoroi gjeneral Henry-n me medaljen më të lartë të tij "Shërbim i shquar" me motivacion "për bashkëpunimin shembullor me Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe kontributin e madh në avancimin e aftësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës". Nga ana e tij gjeneral Henry, theksoi se medalja e ministrit të Mbrojtjes,



është nder i madh për të, duke shprehur edhe kënaqësinë e tij për shërbimin në Kosovë dhe bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Ministrinë e

Mbrojtjes. Ai uroi për të arritjet e deritanishme të FSK-së dhe misionin e tyre në shërbim të sigurisë dhe qytetarëve të Kosovës.

JANË 14 AUTOMJETE USHTARAKE TË BLINDUARA

FSK siguron nga Turqia automjetet ushtarake “Vuran”

Kosova do të jetë shteti i parë i huaj që do të përdorë këto automjete të blinduara me tërheqje të tipit 4x4

Kosova ka nënshkruar kontratën me Turqinë për blerjen e 14 automjeteve ushtarake të blinduara me pajisje të armatimit. Eksporti i parë i makinave turke të blinduara të tipit “Vuran”, të prodhuara në bashkëpunim me firmat e industrisë ushtarake në Turqi, do të arrijnë në Kosovë në vitin 2022. FSK-ja ka kontraktuar blerjen e katër automjeteve të tipit “Vuran” me tërheqje 4x4, ndërkaq që dhjetë të tjerat janë të së njëjtës kompani, por të tipit KIRPI, të pajisura me armatime. Të gjitha këto automjete të blinduara janë pajisje shumëfunksionale. Një pjesë e tyre pritet të arrijnë në Kosovë në fillim të vitit të ardhshëm. Kosova do të jetë shteti i parë i huaj që do të përdorë këto automjete të blinduara me tërheqje të tipit 4x4. Në fazën e parë, dy njësi të automjeteve të blinduara do të prodhohen dhe do të dërgohen në Kosovë. Automjetet “Vuran” prodhohen nga kompania komerciale turke për makina ushtarake, BMC “Otomotiv” në bashkëpunim me firmën më të madhe për pajisjet e mbrojtjes, “Aselsan”. Këto automjete përdoren nga forcat e sigurisë së Turqisë dhe ato kanë lëvizshmëri dhe qëndrueshmëri të lartë, si dhe mund të operojnë në kushte të rënda klimatike dhe terrene të vështira.

FSK-ja merr nga Turqia rreth 100 milionë lira turke ose 9.7 milionë euro në vit si donacion, e të cilat i shfrytëzon për të kontraktuar blerjen e pajisjeve ushtarake po ashtu nga Turqia. Kontratat bëhen në dollarë dhe shuma e tyre lëvizë varësisht nga kursi i këmbimit të lirave turke në dollarë, për shkak se kontratat e blerjes së pajisjeve ushtarake bëhen me dollarë amerikanë. Sigurimi i



pajisjeve ushtarake të FSK-së nga shteti i Turqisë, bëhen në bazë të kërkesës së FSK-së për llojin e pajisjeve, ndërkaq që të gjitha procedurat tjera i kryen shteti turk. Në këtë mënyrë janë siguruar edhe 14 automjetet e blinduara të tipit “Vuran” dhe KIRPI. Më herët Turqia i ka dhuruar FSK-së si donacion automjete të blinduara të tipit “Cobra”. Ndërkohë që gjatë tre vjetëve, FSK-ja ka siguruar pajisje individuale, në vlerën e donacioneve vjetore që i jep shteti turk. Përveç Turqisë, Forca e Sigurisë, deri më tash ka siguruar pajisje ushtarake të llojllojshme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania, Britania e Madhe, por edhe nga vende të tjera, të cilat janë pjesë e aleancës së NATO-s. Në fillim të muajit gusht Forcat e Sigurisë së Kosovës do të marrin edhe 50 automjete të tjera të blinduara të tipit “Humvee”, si donacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Forca e Sigurisë së Kosovës tashmë posedon me 68 të tilla, ku 27 kanë qenë donacion, kurse pjesa tjetër është blerë nga buxheti i Kosovës.

Në dhjetor të vitit 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet ligjore, për të ndryshuar mandatin e FSK-së.

Kësaj force është thënë se do t'i nevojitet një periudhë kohore prej dhjetë vjetësh për t'u transformuar në ushtri me kapacitete të plota. Programi i transformimit parasheh tri faza. Faza e parë do të përfshijë tre vjet, e dyta katër vjet dhe e fundit sërish tre vjet. Kapacitetet e plota operacionale parashihi që të arrihen në fazën e tretë. Por, aktualisht Kosova po shkon drejt përfundimit të fazës së parë. Në përputhje me fazat e transformimit të FSK-së janë duke u zhvilluar edhe trajnimet dhe edukimi i kuadrove brenda kësaj force, por edhe ngritja e kapaciteteve teknike të saj. Sipas tij, Qeveria e Kosovës ka arritur që për vitet 2020, 2021 dhe 2022 të planifikojë ngritjen e buxhetit për FSK-në, i cili i plotëson nevojat e saj dhe krijon mundësi investimi në këtë forcë. Në vitin 2020, buxheti i ndarë për FSK-në ishte rreth 63 milionë euro. Në vitin 2021, buxheti i FSK-së është 67 milionë euro ose rreth 1 për qind e Bruto Produktit Bruto. Kurse për vitin 2022, Qeveria e Kosovës është zotuar të akordojë mbi 100 milionë euro për FSK-në.

Aleanca e NATO-s forcon lidhjet e mbrojtjes midis Maqedonisë së Veriut dhe Portugalisë – u tha në takimin e ministrave të Mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe Zhao Gomesh Kravinju, në 23 korrik në Lisbonë, ku një delegacion nga Ministria e Mbrojtjes dhe Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut i kryesuar nga ministria ndodhej në vizitë zyrtare dy-ditore. Shekerinska u mirëprit nga homologu i saj portugez me nderimet më të larta dhe një ceremoni solemne në të cilën intonacioni i himnit tonë kombëtar u pasua nga toga nderi nga marina për nder të ardhjes së ministres.

Duke falënderuar për ftesën për vizitë, Shekerinska shprehu shpresën se Marrëveshja për Bashkëpunimin Bilateral të Mbrojtjes do të nënshkruhet së shpejti dhe që të dy vendet të kenë një bashkëpunim të suksesshëm. "Portugalia ishte ndër valën e parë të vendeve që filluan ratifikimin e protokollit për pranimin tonë në NATO, të cilin ne e konsiderojmë një akt jashtëzakonisht miqësor dhe vullnet politik për të mbështetur Maqedoninë e Veriut. "Unë jam e bindur se kjo ka krijuar një bazë të mirë për ne që të zhvillojmë bashkëpunim të sigurt dhe të frytshëm si aleatë në Aleancë," tha Shekerinska në takim.

Ministria informoi homologun portugez për planet për integrimin ushtarak të vendit në NATO, të cilat duhet të përfundojnë në fund të këtij viti, si dhe mundësitë e ofruara nga poligoni ushtarak Krivolak, të cilin ne e zhvillojmë si një kapacitet vendor dhe të Aleancës. Ministri Kravinju ripohoi interesin e tij në krijimin e një Marrëveshjeje Bashkëpunimi Bilateral dhe tha se Portugalia vlerëson shumë arritjet e Maqedonisë së Veriut në drejtim të anëtarësimit në NATO dhe kontributin e saj në sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Ai mirëpriti përpjekjet e vendit tonë për të filluar negociatat me BE dhe theksoi se vendi i shteteve të Ballkanit Perëndimor është në BE.

Ministria e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska në Portugali

Maqedonia e Veriut dhe Portugalia fillojnë bashkëpunimin në fushën ushtarake

Stërvitje të përbashkëta midis forcave speciale dhe bashkëpunim më të madh në mbrojtjen kibernetike përmes programit PESCO



Të dy ministrat ranë dakord për stërvitje të përbashkëta të forcave speciale dhe bashkëpunim më të madh në mbrojtjen kibernetike, për të cilën ministri Kravinju shprehu gatishmërinë për të siguruar mbështetje përmes programit PESCO, veprimtaritë e të cilit koordinohen nga Portugalia. Delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës gjithashtu vizitoi Komandën e Përbashkët të Operacioneve-

selinë operacionale për misionet e NATO-s, OKB-së dhe BE-së jashtë vendit, ku ata patën informime dhe bisedime me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Portugeze, Admiral Antonio Silva Ribero. Delegacioni gjithashtu vizitoi Akademinë e Komunikimit dhe Informacionit të NATO-s, si dhe shkollën ushtarake për trajnime dhe stërvitje për misione të huaja, këmbësori, njësi të mekanizuara dhe artileri.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë maqedonase, Gjeneralletënant Vasko Gurchinovski, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Turqi, ku është pritur, ka zhvilluar bisedime dhe ka firmosur një marrëveshje me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneral Yaşar Guler.

Pas nderimeve ushtarake, gjeneralët Gurchinovski dhe Guler kanë diskutuar lidhur me bashkëpunimin dypalësh ushtarak, por edhe intensifikimin e mundësive për zgjerimin e mëtejshëm ushtarak, përmes formave të reja të bashkëpunimit të përbashkët si: trajnimet dhe stërvitjet e përbashkëta, pjesëmarrja në misione dhe përdorimin e kapaciteteve të dy ushtrive.

Gjenerali Gurchinovski shprehu mirënjohjen e tij për Gjeneral Guler, për mbështetjen dhe ndihmën pa rezervë të ofruar nga Republika e Turqisë, jo vetëm në procesin e integritetit, por edhe në anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. Gjeneral

Maqedonia e Veriut-pjesë e grupit luftarak të Aleancës në Letoni

Mundësitë për përfshirjen e Maqedonisë së Veriut në të ashtuquajturën "Prania e Përforcuar e Shpërndarë" e Aleancës në Letoni, brenda kontingjentit Slloven ishte një nga temat e diskutuara më 7 korrik 2021, në Riga nga ministrat e Mbrojtjes të Maqedonisë së Veriut, Radmilla Shekerinska, Sllovenisë, Matej Tonin dhe Malit të Zi, Olivera Injac, gjatë një vizite pune të organizuar nga ministri i Mbrojtjes së Letonisë, Artis Pabriks.

"Maqedonia e Veriut, si aleate e përkushtuar e NATO-s, mbështet plotësisht vlerat e Aleancës dhe beson fort në shtyllën e NATO-s - mbrojtjen kolektive dhe gatishmërinë për të garantuar bashkërisht paqen dhe stabilitetin në të gjithë zonën euroatlantike", -tha ministria Shekerinska gjatë një vizite në bazën ushtarake Adaxha. Tre ministrat bënë një vizitë dhe u takuan me ushtarët dhe me strukturën komanduese.

Shekerinska theksoi se prania e tre ministrave nga rajoni, në veri të Evropës, i dërgon Aleancës një mesazh të fortë aleance dhe solidariteti.

Ministria porositi se Armata maqedonase përmes pjesëmarrjes në misionin KFOR në Kosovë tashmë

Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Sllovenia kanë bashkëpunim të shkëlqyeshëm dypalësh të ndërsjellë, i cili hapi rrugën për kontribut të përbashkët në "Prania e Përforcuar e Shpërndarë"



po jep një kontribut të rëndësishëm në stabilitetin rajonal, por gjithashtu se ekziston një gatishmëri së bashku me Slloveninë dhe Malin e Zi për të marrë pjesë të përgjegjësisë brenda grupit luftarak të Aleancës në Letoni.

"Përvoja e shkëlqyeshme deri më tani në proceset e përbashkëta rajonale, si dhe kontributi i përbashkët rajonal në misionet ISAF dhe 'Mbështetje e Vendosur' në Afganistan, janë dëshmi se aleatët e Ballkanit në NATO funksionojnë mirë në kontingjentet e përbashkëta dhe se të tre vendet e rajonit do të

përfitonin nga kjo pjesëmarrje e përbashkët, por edhe të gjithë Aleancën", -tha ministria Shekerinska dhe shtoi se Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Sllovenia kanë bashkëpunim të shkëlqyeshëm të ndërsjellë, i cili hapi rrugën për kontribut të përbashkët në "Prania e Përforcuar e Shpërndarë".

Ministrat kanë mbajtur një briefing me komandantët e Brigadës së Mekanizuar të Forcave Tokësore të Letonisë, Sandris Gaugers dhe të Forcave Speciale Kanadeze, Zhan-Franso Çauden, si dhe kanë vizituar bazën e misionit dhe selinë e kontingjentit slloven. Vizita e përbashkët në Letoni është një hap tjetër në frymën e forcimit të bashkëpunimit rajonal të mbrojtjes midis Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Sllovenisë, që u intensifikua veçanërisht pas anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO.

SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM VIZITË ZYRTARE NË TURQI

Gurchinovski-Guler: Bashkëpunimi ushtarak me Turqinë do të vazhdojë

Gurchinovski gjithashtu vuri në dukje pjesëmarrjen e përbashkët në operacionet paqeruajtëse, veçanërisht në Afganistan, ku një numër i madh i misionëve kanë qenë nën patronimin e kontingjentit turk.

Delegacioni i ushtrisë maqedonase i drejtuar nga gjeneral Gurchinovski ka vizituar Komandën e Forcave Speciale turke, si dhe një pjesë të industrisë ushtarake turke.

Republika e Turqisë, si partneri strategjik i Maqedonisë së Veriut, është një faktor dhe kontribuues i

rëndësishëm në modernizimin e ushtrisë maqedonase dhe pajisjen e saj me mjete të reja, moderne, të përputhshme me standardet e vendeve anëtare të NATO-s, përfshirë dhurimin më të fundit të disa automjeteve ushtarake. Si pjesë e bashkëpunimit të ndërsjellë ushtarak, Ushtria e Republikës së Maqedonisë Veriore ka marrë pjesë në 13 misione në Afganistan, në operacionin e NATO-s, "Mbështetje e Vendosur", konkretisht në Shtabin e Përgjithshëm të Komandës së Trajnimit, Këshillimit dhe Ndihmës në Kabul.

NATO shënon 60 vjetorin e patrullimeve ajrore evropiane

RAMSTEIN, Gjermani: NATO më 1 korrik 2021, shënoi 60 vjetorin e punës së Aleancës për të mbajtur të sigurt qiejt dhe territoret evropiane. Që nga 1 korriku 1961, aleatët kanë punuar së bashku duke integruar rregullat dhe aftësitë e tyre të Mbrojtjes Ajrore për të siguruar Mbrojtjen Ajrore të koordinuar, të ndërlidhur dhe kolektive. Ky mision i përhershëm i NATO-s vazhdon pa u ndalur edhe sot dhe do të zhvillohet për të përmbushur sfidat e ardhshme të sigurisë. Për gjashtë dekada, Policimi Ajror ka qenë një mënyrë e rëndësishme për NATO-n për të mbajtur popullsinë e saj të sigurt. Ky është një shembull i qartë i solidaritetit të Aleancës në veprim, duke demonstruar se NATO ka aftësitë dhe vendosmërinë për të mbrojtur të gjithë aleatët.

"Për gjashtë dekada, Policimi Ajror ka qenë një mënyrë e rëndësishme për NATO-n për të mbajtur njerëzit tanë të sigurt. Në të gjithë Evropën, avionët luftarakë të NATO-s janë në detyrë gjatë gjithë kohës për të ruajtur hapësirën ajrore të aleatëve tanë. Ky është një shembull i qartë i solidaritetit të Aleancës në veprim, duke demonstruar se NATO ka aftësitë dhe vendosmërinë për të mbrojtur të gjithë aleatët", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në Selinë e NATO-s në Bruksel. "Pilotët dhe ekuipazhet po bëjnë një punë të rëndësishme dhe unë dua t'i falënderoj ata për përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre. Të gjithë aleatët u detyrohen një mirënjohje të thellë. NATO mbetet vigjilente. Dhe siç u dakordua



Ky mision i përhershëm i NATO-s vazhdon pa u ndalur edhe sot dhe do të zhvillohet për të përmbushur sfidat e ardhshme të sigurisë

në Samitin tonë të fundit, ne do të përshpejtojmë inovacionin dhe të vazhdojë të investojë në teknologji të reja, për të mprehur avantazhin tonë teknologjik në një botë më konkurruese", tha ai.

"Gjatë 60 viteve të fundit, burra dhe gra nga forcat ajrore në të gjithë Aleancën kanë qenë të gatshëm të reagojnë 24/7 për të mbrojtur hapësirën ajrore të NATO-s nga çdo kërcënim. Kjo nuk ka ndryshuar," tha Komandanti i Komandës Ajrore Aleate, SHBA gjenerali i Forcave Ajrore Jeff Harrigian, duke nënvizuar rëndësinë e vazhdueshme të misionit kolektiv të Policimit Ajror. "Sot, në një mjedis sigurie dinamik dhe sfidues, stafi i Policisë Ajrore të NATO-s nga e gjithë Aleanca mbetet vigjilent dhe i gatshëm të përgjigjet si një ekip i shkathët, shumë-kombëtar", shtoi ai.

Komanda e gjeneral Harrigian në Ramstein, Gjermani, mbikëqyr një sistem të integruar të sistemeve që përfshijnë komandat ajrore dhe qendrat e kontrollit, stacionet e mbikëqyrjes ajrore dhe, më të dukshmet, avionët luftarakë në gatishmëri të vazhdueshme në të gjithë territorin evropian të NATO-s, të gatshëm për të mbrojtur aleatët në emër të komandantit suprem të aleancës së NATO-s, në Evropë.

"Ne kemi mbështetur dhe përmirësuar Policimin e Ajrit për 60 vjet ndërsa mirëpresim shumë anëtarë të rinj në NATO dhe duke u zotuar për integritetin territorial dhe sigurinë e hapësirës sonë ajrore dhe kauzën e paqes," tha gjeneralmajori i Forcave Ajrore të SHBA Phillip Stewart, Zëvendës Shefi i Shtabit i Punës Strategjike. "Nga të gjithë ne në Selinë e Lartë të Forcave Aleate të Evropës, u themi falënderime të gjithë burrave dhe grave nga e gjithë Aleanca për gjithçka që kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë, për të mbështetur paqen," përfundoi ai.

Duke ecur përpara, NATO do të vazhdojë të zhvillojë aftësitë e saj kolektive përmes inovacionit duke përdorur teknologjinë më të përparuar duke përmirësuar më tej ndërgjegjësimin e situatës, duke ushtruar operacione me shumë fusha dhe duke integruar avionët të gjeneratës së pestë. "Si një aviator, jam krenar që qëndroj përkrah burrave dhe grave të 30 Kombeve Aleate që vazhdojnë të kontribuojnë në misionin e Policimit Ajror të NATO-s, faleminderit," tha gjenerali Harrigian dhe dha një vlrësim për ata që kanë qenë prapa historisë së suksesit të NATO-s për kolektivin e mbrojtjes ajrore për gjashtë dekada.

Forcat ajrore dhe detare të NATO-s kryen stërvitje të mbrojtjes ajrore në brigjet e Rumanisë më 2 korrik 2021, duke siguruar që forcat aleate të qëndrojnë të gatshme e të veprojnë së bashku në rajonin strategjik të Detit të Zi. Manovrat një ditore panë avionët luftarakë grekë dhe turq të prodhonin mbrojtjen ajrore të Grupit të Dytë Detar të Përhershëm të NATO-s, i cili është aktualisht në rajon. Stërvitjen e mbështetën një avion i Sistemit të Paralajmërimit dhe Kontrollit Ajror të NATO-s, një avion patrullues turk dhe avionë luftarakë rumunë. Stërvitja u zhvillua paralelisht me Sea Breeze 2021, stërvitje e madhe vjetore detare në Detin e Zi, me 5,000 trupapjesëmarrës nga NATO dhe vendet e tjera dhe rreth 30 anije dhe 40 avionë.

RAMSTEIN, Gjermani: Më 2 korrik 2021, Forcat Ajrore dhe Detare të NATO-s zhvilluan një Ushtrim të Mbrojtjes Ajrore (ADEX) në Detin e Zi për të përmirësuar bashkëpunimin e Aleancës, për të praktikuar komunikimet ajrore-detare dhe për të ndërtuar marrëdhënie më të forta midis aleatëve. Pjesëmarrja përfshinte asete luftarake aleate nga forcat ajrore greke, rumune dhe turke, një AWACS i NATO-s, një avion rumun transportues C-27, një Avion Patrullues Usharak turk dhe tre fregata aleate nga Grupi 2 i Përhershëm Detar i NATO-s, (SNMG2), anije e Marinës Italiane Fasan, marina rumune Regina Maria dhe marina turke Barbaros. Forcat SNMG 2 që tranzituan përtej Detit të Zi, do të marrin pjesë në Ushtrimin Fllad i Detit 2021 pas ADEX.

Ndërsa fillimisht avionët luftëtarakë të Forcave Ajrore Turke F-16 simuluan sulmet ndaj anijeve të NATO-s të cilat kryenin stërvitje mbrojtëse kundër këtyre sulmeve, F-16 greke dhe rumune, në një ngjarje të veçantë, kryen manovra të ngjashme stërvitore me luftarakët grek që sulmonin anijet të cilat u përgjigjën një mënyrë e përbashkët me avionët luftëtarakë rumunë. Më pas, avionët luftëtarakë grekë dhe rumunë zhvilluan stërvitje luftarake



ADEX: NATO zhvilloi stërvitje të mbrojtjes ajrore në Detin e Zi

në ajër.

Ky ushtrim tregon se si aleatët përdorin mundësi unike për të trajnuar forca të shumta aleate në një mjedis me shumë fusha. Duke u ushtruar në ujërat ndërkombëtare dhe hapësirën ajrore afër bregdetit rumun, NATO është në gjendje të zhvillojë më tej taktikat e saj operationale dhe të përsosë koordinimin e hapësirës ajrore me aleatët e Detit të Zi. Ekspertët e Komandës Ajrore aleate në bashkëpunim me Qendrën e Operacioneve Ajrore të Kombinuara në Torrejón, Komandën Detare Aleate dhe kombet pjesëmarrëse planifikuan veprimtarinë për disa javë.

“Në përgjithësi trajnimi i integritetit detar ajror demonstroi aftësitë, gatishmërinë dhe vendosmërinë e NATO-s për të mbrojtur popullsinë aleate; me anijet dhe avionët tanë që veprojnë në mënyrë paqësore në brigjet rumune ne gjithashtu sigurojmë aleatët në rajon,” tha zëvendës shefi i Shtabit i Komandës Ajrore Aleate gjeneralbrigade Andrew Hansen. “Avionët tanë

janë pa municion për të mundur përfitim të maksimal të trajnimit dhe lejimin e ndërveprimit midis katër avionëve luftëtarakë të aleatëve,” shtoi ai.

“Ne kemi rregulla të qarta të komandës dhe kontrollit dhe rregulla të rrepta të angazhimit që çdo pjesëmarrës i njeh. Këto sigurojnë që ne të kryejmë trajnimin në një mënyrë të përgjegjshme dhe de-shkallëzuese ndërsa tregon akoma një prani të besueshme dhe të gatshme të aseteve të NATO-s në rajon”, tha Komandanti i Operacioneve Ajrore të Kombinuara Torrejon, gjenerallejtant Fernando de la Cruz. Aleatët e NATO-s shpesh integrojnë asetet e Aleancës Ajrore dhe Detare për të përmirësuar ndërveprimin, për të ndërtuar besimin dhe për të rritur gatishmërinë në rajonin e Detit të Zi gjatë ngjarjeve të kombinuara të trajnimit. Aktivitetet më 2 korrik nënvizuan angazhimin e aleatëve për mbrojtjen kolektive dhe për të ruajtur paqen dhe sigurinë në këtë rajon si në det ashtu edhe në ajër.

Lufta Civile dhe Provokacionet e 2 Gushtit 1949 në shtypin shqiptar



Dr. ASLLAN ZEMANI
Përgjegjës i Muzeut i Forcave
të Armatosura

Në gjysmën e parë të Shekullit XX trevat shqiptare sikurse ato ballkanike, u përfshinë në një fushë rivaliteti, influencash e interesash politike e ushtarake por sidomos në fundin e viteve '40 (1946-1949), Ballkani u përfshi në një situatë të ndërlikuar ndërkombëtare, ku shtetet perëndimore dhe ato lindore përplaseshin për të siguruar atë që quhej influencë, në vendet e këtij rajoni, me rëndësi të madhe strategjike. Pas Luftës së Dytë Botërore, këto vende u orjentuan në kahje të ndryshme politike; Jugosllavia, kishte filluar jetën e saj sipas doktrinë sovjetike, por shumë shpejtë, vetëm brenda 5 viteve, ajo pati një anim drejtë Perëndimit demokratik; nga ana tjetër, Greqia, përpigjej me çdo kusht, me të gjitha forcat e saj, por edhe me nxitjen, mbështetjen dhe ndihmën në forca ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar si dhe atë financiare, të Shteteve të Bashkuara (Doktrina Truman dhe Plani Marshall), që të mos binte në kthetrat e tutelën sovjetike, e cila me brutalitetin e vet politik e ushtarak, përbënte rrezik tepër serioz.

Lufta Civile në Greqi ndikoi dukshëm në të dyja këto vende, por sidomos në gjashtë muajin e parë të vitit 1949 e më pas, ajo u ndje madje vetëm në Shqipëri, e që për "vet pozicionin poli-

tik e gjeografik, me dashje ose jo, me shtysën jugosllave e sovjetike, ishte e përfshirë në të që herët, madje aktivisht". Vendi ynë, ishte e pothuaj i papërgatitur për t'u përballuar me presionin ndërkombëtar dhe me synimet e drejtpërdrejta greke mbi territorin shqiptar që tashmë, jo vetëm e kishte përpiluar shkresërisht por shumë shpejtë, ajo u ndodh mbi skrinën e Sekretarit të Shtetit Amerikan për siglim e marrje mendimi, e emërtuar "Momerandumi Pipinelis".

Ndërkohë, Shqipëria, me statusin e plotë si "pika më e dobët" apo "hallka e fundit e zinxhirit" e vendeve lindore, vijonte që t'i kishte marrëdhëniet të pa konsoliduara me bllokun e këtyre shteteve. Deri në vitin 1948, Shqipëria kishte firmosur vetëm dy Traktate Miqësie dhe Ndihme Reciproke, me Jugosllavinë dhe me Bullgarinë, ndërsa pas këtij viti, pothuajse nuk egzistonte asnjë siguri ndërkombëtare, për më tepër, gjeografikisht ndodhej larg vendeve të tjera lindore.

Politika e jashtme latente e ndjekur nga qeveria shqiptare deri në fund të vitit 1948, pati marrëdhënie vetëm me Jugosllavinë deri në prag ndërprerjen me të, ajo vijoi aferat e marrëveshjes për vendosjen e një divizioni jugosllavnë Korçë në afërsi direkte me kufirin grek, që në thelb "ishte një rrezik i madh për paqen në Ballkan", si dhe zhvillimi më pas i marrëdhënieve vetëm me BS duke u vendosur me dëshirë tërësisht nën kontrollin e Moskës. Të gjitha ngjarje, sidomos në vitin 1949, ndikuan ndjeshëm në marrëdhëniet me Greqinë, të cilat mbeten gjithnjë të tensionuara, duke mbizotëruar mosbesimi dhe frika reciproke. Politika sovjetike, "për të dalë vet a nëpërmjet klientelës sllavo-ortodokse ballkanike në brigjet e Adriatikut e të Mesdheut", duke lënë në periferi interesin e zgjidhjes së problemeve shqetësuese shqiptaro-greke, e mbështeti angazhimin e Shqipërisë vetëm sipas

leverdisë së saj. Për Shqipërinë rreziku rritej e shtohet akoma më shumë edhe për shkak të pozicionit të lakmueshëm gjeostrategjik që kishte në Ballkanin Perëndimor.

Zhvillimet dramatike të vitit 1948 në Pindin Verior, sidomos në gjysmën e dytë të vitit, kur Ushtria Kombëtare Greke me mbështetjen e gjithanshme amerikane, vijonte përgatitjen ushtarake për dhënien fund të Luftës Civile ndërsa qeveria greke, "ëndërronte" mbi "argumentin" e pretendimeve territoriale për aneksimin e Shqipërisë së Jugut duke shfrytëzuar të ashtuquajturën "Marrëveshja të Korfuzit" për "Autonominë e Shqipërisë së Jugut", nevojën e pushtimit ushtarak të Shqipërisë së Jugut.

Pikërisht, në prag përfundimit e këtyre përgatitjeve, qeveria greke u përcolli Aleatëve Perëndimor "Momerandumin Pipinelis", për goditjen nga Brenda në territorin shqiptar. Mbështetësit kryesor, amerikanët, jo vetëm e kundërshtuan por kërkuan nga Athina, siguri për mos kryerjen e veprimeve të tilla. Ky fakt, tashmë, na përcillet nga deklasifikimi i dokumenteve, të cilat hedhin dritë dhe na bindin duke na sjellur në vëmendje konfirmimin e deklaratës së ambasadorit amerikan Cannon në Jugosllavi "se qeveria amerikane nuk do t'i përkrahë ndofarë masash të qeverisë greke për ndryshimin e kufirit shqiptaro-grek me përdorimin e forcës" që do të "...bënin të nevojshme të vlerësoheshin lidhjet që kishin zhvillimet aktuale dhe të ardhme në Shqipëri me objektivat dhe interesa afatshkurtër e afatgjatë amerikane, për të krijuar një kuadër politik në të cilën do të zgjidheshin problemet aktuale dhe ato që do të krijoheshin në të ardhmen". Gjithsesi, amerikanët për shumë arsye, pranuan mundësinë e veprimeve mësimse me objektiva të kufizuara në brendësi të territorit shqiptar dhe një i tillë ishte provokacioni i 2 gushtit të vitit 1949,

i cili përfundoi pa sukses.

Vetëm duke mbajtur parasysh një sërë zhvillimesh historiko-politike të shtrira në hapsirë dhe në kohë për këtë periudhë fare të vogël kohore, do të mund të bënim një gjykim realist në lidhje me ngjarjet e 2 gushtit 1949, mes Greqisë dhe Shqipërisë, ku krahas ngjarjeve e problematikave të shumta paralele që shoqëruan këto veprime luftarake ishte dhe pasqyrimi i tyre në shtypin e përditshëm shqiptar të asaj periudhe....

Institucionalizimi i medias shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore

Në periudhën midis viteve 1920-1940 një sërë gazetarësh të shquar dhe mendimtarësh shqiptarë ishin autorë në gjini të ndryshme shkrimesh, të cilët, të organizuar rreth gazetave dhe revistave më të rëndësishme të kohës si: "Drita" e Veli Hashorvës, "Demokratia" e Xhevat Kallajxhiut, "Labëria" dhe "Ideja kombëtare", "Fletore Popullore e Politike Kombëtare", "Epoka e re" e Halit Tugit, e përjavshmeja "Bisedë e lirë" dhe gazeta politiko-shoqërore "Fletore popullore" e Petro M. Haritos "Neoshqiptarizma", dhe "Përpjekja Shqiptare" të Branko Merxhanit, "Liceisti", e shumë gazeta të tjera lokale që dolën në Delvinë, Përmet, Labëri, Libohovë, Himarë e gjetkë. etj., u përpoqën që përmes përkushtimit të tyre intelektual të realizonin një Rilindje të Re Kombëtare, të orientuar për nga kultura, mendimi dhe Perëndimi. Idetë progresive, kura-joja dhe bota e tyre krejt e veçantë mendore, në kontrast me gjendjen ekonomike dhe sociale të asaj kohe në Shqipëri, solli në mjedisin shqiptar një erë të re, që pa më të voglin dyshim mund të konsiderohet si periudha më e artë në krejt historinë e shtypit shqiptar, mbase të të gjitha kohërave. Gazetaria dhe publicistët e asaj periudhe publicistike, janë shembulli më origjinal i kristalizimit në Shqipëri të një tendence të pastër intelektuale që synonte analizën e aktualitetit të asaj periudhe, rindërtimin historik të së shkuarës dhe një orvajtje e guximshme për të vendosur bazat e zhvillimit në të ardhmen.

Në kolonat e këtyre gazetave dhe përtjejes rreshtave, tek idetë e reja të botuesve dhe autorët artikullshkrues si, Branko Merxhani, Jorgji Meksi, Xhevat Kallajxhi, Vangjel Koça, Petro Marko, Nonda Bukla, Veli Hashorva, Petro Harito, Ismet Toto, Ihsan Libohova, Avni Rustemi, Ikbale e Nebil Çika, Sali Nivica, Lumo Skëndo, Mihal Grameno, Omer Nishani, Bajo Topulli, Mihal Zallari, Odise Paskali, etj., dallohej qartazi se një rrymë e re intelektuale po depërtonte në shoqërinë shqiptare në periudhën mes dy luftërave botërore.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë

Botërore, madje qysh në gjysmën e dekadës së parë të lirisë së vendit, gazetaria shqiptare hodhi hapat e para të organizimit të saj sipas platformës së vendeve të Lindjes. Në të gjithë ecurinë e veprimtarinë e saj, ajo e ushtroi në kushte të caktuar politike, ideologjike e gjeostrategjike. Ajo pasqyroi tërësisht karakteristika e përmbytje tipike, si të brendshme edhe të jashtme; me lidhje, ndërvarësi e ndi-



kime pazgjidhshmërisht të ndërsjellta të problemeve më kryesore politike e ideologjike nëpërmjet mesazheve informative që ofronte vetë pushteti. Njëkohësisht, për gjashtë mujin e dytë të viti 1949, ajo pasqyroi gjendjen, rreth e ndaj nesh e mbingarkuar kryesisht në rrjedhojë të problematikës ballkanike e mes shteteve kufitare me Shqipërinë, historikisht me kundërshti e armiqësi në kushtet e ndarjeve të mëdha ideologjike-politike e ushtarake, karakteristike të pas Luftës së Dytë Botërore.

Në rastin shqiptar, mediat, menjëherë si edhe me shtetëzimet e mëdha, që shoqëruan vitet e para të jetës së klasës politike të sapo ardhur në pushtet, u përfshinë edhe ato në këtë hulli duke funksionuar si të gjitha institucionet e tjera shtetërore e pjesë e administratës, natyrisht sipas hierarkisë që kushtëzonte modeli i huazuar sovjetik.

Shteti i instaluar në Shqipëri me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, erdhi së bashku me mediat e tij të reja, po edhe të tjera, deri diku ekzistuese e që pas luftës, ndërruan edhe misionin, nga media që luftonin dikur së bashku me Ushtrinë Nacionalçlirimtare për çlirimin e vendit, në media që luftonin për ndërtimin e "demokratik" të vendit, sipas modelit socialist, duke u kthyer në shërbyesë të përlulura në duart e pushtetit.

Drejtuesit e vendit që morën në dorë shumë shpejt edhe drejtimin e sistemit mediatik, ishin të vetëdijshëm për rëndësinë e shtypit, të medias në përgjithësi, e cila jo pak kishte kontribuar në luftë, por dhe të bindur për nevojën e përdorimit të saj në funksion

të shpërndarjes apo shpërhapjes së propagandës mbizotëruese politike.

Njëkohësisht ky shtyp i ri u bashkëshoqërua me organizata të masave, siç do t'i shohim më vonë, dhe shumë shpejt secila prej këtyre organizatave do të ketë gazetën e vet. "Në pragverën e atij viti nuk kishte asnjë prefekturë pa një bazë poligrafike e, së paku, një gazetë. Fronti, rinia, pionierët, gruaja antifashiste dhe ushtria

kishin organet e shtypit të tyre. Në shtator të 1945-ës qytetet kryesore të Shqipërisë ishin vënë në garë për të nxjerrë edhe gazeta të profiluara. Deri në atë kohë, përveç shtypshkronjave ekzistuese, ishin ngritur edhe disa të reja, si në Gjirokastrë, Berat e Peshkopi". Më i rëndësishmi prej tyre, ishte Fronti. Siç cilëson edhe Hannah Arendt (1906-1975-politikolog, filozof dhe historian gjerman, natyralizuar amerikan pas tërheqjes së shtetësisë gjermane në vitin 1937. Punoj si gazetar dhe profesor universiteti dhe botoi vepra të rëndësishme të filozofisë politike), tek botimi "Origjinat e totalitarizmit", "... Organizatat e frontit e rrethojnë anëtarësinë e lëvizjeve me një mur mbrojtës, i cili i ndan ato prej botës së jashtme, normale; njëkohësisht, ato formojnë një urë lidhëse me normalitetin, pa të cilin anëtarët në stadin parapshtet do t'i ndjenin fort ndryshimet midis besimeve të tyre dhe atyre të njerëzve normalë, midis trillimit të nënkuptuar të llojit të vet dhe realitetit të botës normale. Çiltërsia e kësaj sajese, gjatë luftës për pushtet të lëvizjeve, është se organizatat e frontit jo vetëm i izolojnë anëtarët, por u ofrojnë atyre një përngjasim të normalitetit të jashtëm, i cili shmang ndikimin e realitetit faktik në mënyrë më të efektshme se indoktrinimi i thjeshtë".

Më 14 prill 1947, në një qarkore të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, dërguar aparateve të saj nëpër rrethe, shkruhet; "Sot del nevoja të përqëndrojmë ndër organet e propagandës të gjithë punën politike, kulturore dhe arsimore, domethënë gjithçka që lidhet me ideologjinë e

Partisë. Në Shqipërinë e re janë krijuar konditat për një veprimtari politike e kulturore-arsimore të gjerë, por puna është se këto duhet drejtuar dhe organizuar nga Partia". Kjo dëshmon se shtypi, ashtu si dhe sektorë të tjerë si arsimit e kultura, konsideroheshin pjesë përbërëse të sistemit të propagandës së partisë në fuqi dhe vendosen nën kontroll të drejtpërdrejtë.

Ndonëse sapo kishte ardhur klasa e re politike në pushtet ende vijonte liberalizimi rudimentar që ishte trashëguar nga e shkuara pluraliste e shtypit shqiptar por edhe në kohën

të Partisë Komuniste, përkundrejt Frontit, dhe marrjen e kontrollit prej saj, rinis botimi i së përditshmes "Zëri i Popullit", organ i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste. Gazeta "Bashkimi" kalon në plan të dytë dhe e gjithë veprimtaria gazetareske fillon të bëhet pikë reference. Sipas Naim Zotos botuar në "Media Shqiptare", edhe leximi i shtypit që prodhohej nga këta mekanizma të propagandës dhe në shërbim të pushtetit, siç i quan ai, janë nga ana tjetër ushqim po për këtë kategori të shoqërisë, për anëtarët e partisë: "Gazeta "Zëri i popullit" ar-



e Luftës Nacionalçlirimtare. Duke rrjedhë nga një traditë dhe mendësi që nuk i njihje kufijtë e të shprehurit, këta personalitete vazhduan të shkruajnë me parimet e tyre liberale, dhe pikërisht për këto u dënuan më pas. "Këta janë njerëz që janë futur në lëvizjen antifashiste dhe çlirimtare nga mjedise familjare të kulturuar, me tradita nacionaliste, që kanë dalë nga shtresa shoqërore relativisht të zëna ekonomikisht dhe të paangazhuara në radhët e Partisë Komuniste. Pas vitit 1946, sidomos pas goditjes që mori i ashtuquajtur "grupi i deputetëve" në Asamblenë Legjislative, u dënuan jo vetëm deputetët që bënë pjesë në të-pushtet, internimem burgosje me afate të zgjatura-por gazetarët, për të cilët mendohej se përcillnin frymën demokratike, liberale dhe properëndimore të këtij grupi".

Ndërkohë, vendi hyri në një hulli tjetër politike dhe gradualisht nuk do të ishte më Fronti Nacionalçlirimtar, që mendohej se do të ishte baza e pushtetit të ri, por partia komuniste në rrjedhat e modelit sovjetik por e ndikuar politikisht nga udhëheqja jugosllave. Pikëpamjet e shprehura në gazetën Bashkimi prej publicistëve të përmendur nacionalistë, liberal apokomunistë të moderuar, vlerësohen prej partisë komuniste si të djathta dhe shoqërisht të dëmshme".

Mbas '48-ës fryma e përgjithshme në shtypin e kohës dhe mjedisin gazetaresk ndryshon edhe për një arsye tjetër. Me forcimin e pozitave

rinte deri në 140 mijë kopje, shumica destinuar për anëtarët e partisë...". Organi mediatik i partisë, orientonte punën e të gjithëve. Periudha e ekzistencës së alternativave të të menduarit përfundon, e po kështu edhe artikujt "e ndryshëm" nuk hasen më.

Sigurimi i kuadrit të përshtatshëm për realizimin e misionit në mediat shqiptare të pasluftës së Dytë Botërore nëpërmjet shkrimeve të dhura, ka qenë një ndër problemet e rëndësishme të fazës së parë të jetës së shtypit të kohës.

Por kush do ta bënte këtë punë?

Vendi doli analfabet nga lufta, dhe siç kujtonte Myzejen Shuteriqi rreth 25 vite më vonë, "Shumë nga ne që shkruam në atë kohë nuk e dinim se ç'ishte gazetaria dhe as që kishim shkruar ndonjëherë...". Gazetarët e përzgjedhur me kujdes i përkisnin një shkallë të lartë besueshmërie e besnikërie ndaj shtetit shqiptar e padyshim edhe ndaj PKSH, që nga fundi i vitit 1948 doli tashmë me emrin e vërtetë në skenën politike shqiptare. Për realizimin e misionit të gazetarit, krahas dëshirës së tyre, ishin të përzgjedhur edhe nga vet politika e partisë të sapo legalizuar. Kjo përzgjedhje e këtyre kontingjenteve të tilla nuk ishte risi e sistemit tonë por edhe shembujt e ndryshëm, që vinin sidomos nga Europa Lindore, zgjidheshin nga kritere të përbashkëta, si vlera morale por edhe atdhetare e lidhur ngushtë me kontributin e familjeve e deri të fiseve ndaj vendit tonë.

"Në vijim të traditës së shtypit të periudhës së luftës, në gazetën e pasqirimit, si organizatorë e redaktorë hynë të rinj, djem e vajza, me arsim të mesëm ose me 2-3 klasë gjimnaz". Natyrisht përparësi në përzgjedhje merrnin këta individë, që vetë ose pjesëtarë të familjeve të tyre ishin aktivizuar me armë në dorë kundër pushtuesit për lirinë e Atdheut gjatë periudhës së LANÇ-it, lufta më e afërt që paraprinte pushtetin e sapo vendosur.

Por nga ana tjetër një pjesë e mirë e të angazhuarve në shkrimin, organizimin dhe botimin e shtypit ishin edhe intelektualë, si: "Nako Spiru, Omer Nishani, Medar Shtylla, Sejfulla Malëshova, Misto Treska, Nuri Huta, Fatmir Gjata, Gjovalin Luka, Andon Mara, Andon Kuqali, etj., që kishin zëvendësuar elitën e vjetër të gazetarëve të viteve '30-'40, të cilët ose ishin në burg ose kishin kërkuar strehim politik në Perëndim". Në këtë periudhë u ndalua botimi i çdo organi alternativ si dhe ato të transmetimeve radiofonike.

Të gjitha komunikimet publike kontrolloheshin nga partia-shtet, që në mënyrë paradoksale deklaronte formalisht lirinë e shtypit, madje kjo sanksionohej edhe në ligjin për shtypin, i botuar në vitin 1947, ku në nenin 1 thuhej: "Shtypi në Republikën e Shqipërisë është i lirë. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji, çdo njeri është i lirë të shprehë mendimet e veta nëpërmjet shtypit".

Fuqia propagandistike e medias e kuptuar që herët nga kabineti i ri i drejtimit të vendit (që me lëvrimin e shtypit ilegal gjatë luftës), jo vetëm vlerësohej seriozisht por në të shumtën e rasteve kishte edhe përparësi. Në "Raportin mbi aktivitetin dhe detyrat e reja të Frontit, mbajtur në mbledhjen e dytë të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik", të datës 7 tetor 1946, thuhet: "... Shtypi të shpërndahet dhe të lexohet nga të katër anët dhe ky të jetë një shtyp jo vetëm informativ, por sidomos edukativ dhe të pasqyrojë jetën dhe frymën e re...". Komunikimet masive të medias në Shqipërinë e periudhën fellimore komuniste u shtuan shumë shpejt, kryesisht brenda hapësirës territoriale të Republikës, por edhe jashtë shtetit me botime të veçanta.

Tiparet themelore të shtypit të kesaj periudhe përcaktoheshin nga jehona, që ai i bënte vijës së partisë në pushtet, madje, çdo gjë që botohej në faqet e këtyre gazetave e revistave, apo në buletinet e Agjencisë Telegrafike Shqiptare, duhej të përputhej plotësisht me detyrat dhe interesat e partisë e të shtetit". Zëri i popullit, dilte në 150-160 mijë kopje, në një kohë kur disiplina ideologjike po rreptësohej në shkallën më të lartë.

Një tjetër tipar domethënës, i partishtërisë që përshkonte krejt veprimtarinë publicistike shqiptare, ishte edhe ndikimi shumë i shpejtë në stereotipizimin e gazetarëve të rinj. Pothuajse të njëjtat kërkesa që ngriheshin për gazetarët dhe korrespondentët e rinj ishin dhe ato të kandidatëve për në parti, ashtu siç udhëzonin edhe vendimet e Kongresit të Parë të Partisë Komuniste Shqiptare, të 8-22 Nëntorit 1948.

Kontrolli i centralizuar, madje deri në detaje, qysh në hapat e para të gazetarisë së sapo shkruar u vu re dhe u vendos madje në gjysmën e parë të vitit 1945, siç pohon edhe vetë E. Hoxha në vëllimin e tretë të veprave të tij: "... Në lëmin e kulturës dhe të propagandës, në një kohë shumë të shkurtër qeveria jonë ka bërë një punë të madhe" e më pas, ky kontroll, u institucionalizua me ngritjen e "Sektorit të Shtypit dhe të propagandës", që u përmend edhe në raportin e mbajtur në emër të Qeverisë Demokratike, në sesionin e tretë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, më 26 shtator 1945.

Shtypi shqiptar për provokacionet greke

Provokacionet e shumta dhe agresioni monarko-fashist grek me objektiva të reduktuar kundër vendit tonë gjetën një pasqyrim të shumëllojshëm në peridikun shqiptar por edhe në median shqiptare e ndërkohë vihat re se edhe mediat e huaja por edhe ato fqinjëve tanë ballkanik u përfshinë në këtë hulli. Në kuadrin e "rëndësisë së madhe etnike dhe strategjike" të Epirit të Veriut për Greqinë, sipas Caldarisit, Gazeta "Elinikon Melon" e 30 korrikut, botoi një hartë me pretendimet greke për gjysmën e Shqipërisë, duke njoftuar, se grekët që janë këtu, duhen "çliruar dhe bashkuar me tokën mëmë, bashkë me territorin ku ata jetojnë". Ndërsa edhe gazeta jugosllave "Gllas", njoftonte më 31 gusht të dhëna mbi librin e kundëradmiralit grek Perikles Argiropulos "Pretendimet e Greqisë", në të cilin shtjellohej një plan i ndarjes së Shqipërisë midis Greqisë dhe Jugosllavisë. Të dy këta artikuj u bënë pararendës të fillimit të agresionit të 2 Gushtit 1949 nga monarko-fashistët grekë. Më 29-30 janar të vitit 1949 u mbledh Plenumi V i KQ të PKG, i cili analizoi situatën.

Problemet dhe mangësitë që dolën nga konkluzionet të analizuar në Plenumin V i KQ të PKG, më 29-30 janar të vitit 1949, gjetën një pasqyrim të gjerë në shtypin shqiptar nëpërmjet artikujve tematikë mbi krahun ushtarak të PKG, si ai për përballimin me "guxim të ekspeditave të armikut" ndonëse "nuk u arrit të realizohet qëllimi kryesor strategjik" si dhe sigurimi

i rezervave njerëzore e materiale nga Ushtria Demokratike Greke (UDG). Shtypi shqiptar vijoi që të botonte artikuj të tjerë me tematikë mbi forcat monarko-fashiste që megjithë ndihmën amerikane, epërsin dhe armatimin modern nuk ia arritën qëllimit për asgjësimin e Ushtrisë Demokratike gjatë vitit 1948. Në disa raste paraqitet si shumë e rëndësishme përshkrimi në detaje të të gjitha deklaratave dhe fitoreve të Ushtrisë Demokratike Greqisë, kundër asaj kombëtare. Disa suksese të mëdha u deklaruan nga UDG, jo vetëm në rritjen e resurseve njerëzore të saj, në rreth 20 000 luftëtarë por tashmë edhe në rritjen e fuqisë sulmuese, ishin tematikat e tërësisë të artikujve që botohej në periodikun shqiptar të asaj kohe. Një pjesë e artikujve të tjerë të shtypit tonë bënin të ditur vlerësime të natyrave të tjera për Ushtrinë Demokratike Greke, për vendosjen e paqes si dhe për vrasjen e grekëve të pafajshëm apo dhe se lufta e tyre ishte për pavarësi duke treguar se shtypi jo vetëm ishte i kontrolluar rreptësisht nga politika e kohës por edhe jo i vërtetë me lexuesit e vetë.

Sidoqoftë, shtypi i kohës ndër të tjerash, u përpoq që nëpërmjet shkrimeve me tematikë nga këto ngjarje, t'i ndërkombëtarizonte e duke i bërë të njohura ngjarjet që po ndodhnin në kufirin tonë jugor. Ajo botoi mjaft artikuj në lidhje me një mbështetje të caktuar që u dha grupeve të ndryshme nëpër botë deri tek strukturat e organizuara të krahut komunist grek, Ushtria Demokratike Greke. Artikuj të tillë ishin shkruar nga grupe studentësh në Londër, të cilët protestuan edhe përpara Ambasadës Greke atje e deri në Këshillin Amerikan të Luftës Greke, i cili i dërgoi Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) një peticion, për të ndaluar furnizimin me armë të Ushtrisë Kombëtare Greke. Artikuj të tillë propagandues e mbështetës për Ushtrinë Demokratike Greke e popullin grek kishin një ndikim të veçantë për situatën e brendshme të vendit e popullit tonë, i cili e kishte kurorëzuar me sukses luftën e tij antifashiste e duke fajtuar për këto ngjarje, mbështetësit kryesor të Luftës Civile në Greqi, SHBA-në dhe Britaninë e Madhe. E gjithë kjo propagandë intensive gati e përditshme e artikulluar me terminologjinë e kohës e mbështetur nga PKSh-ja "Për vendosjen e paqes në Greqi" ndikonte shumë tek masat popullore e aq më shumë tek njerëzit e thjeshtë për mbështetjen e rrugës së duhur e të drejtë të kësaj kauze, pasi e gjithë bota po vepronte kështu. Bjellorusia, si pjesë e kampit të demokracive popullore, kërkoi ndërprerjen e sulmeve ndaj komunistëve grekë, një fakt që tregonte, se po thuaj i gjithë Kampi i demokracive popullore ishte me UDG-në.

Në artikujt e perodikëve të ndryshëm të shtypit shqiptar, përcilleshin e komentoheshin sukseset e ndryshme të Ushtrisë Demokratike Greke kur ajo ishte në kulmin e aktivitetit të saj kryesisht në gjashtëmuorin e parë të vitit 1948, njëkohësisht u anatemuan si gjithmonë edhe mbështetësit e tyre, SHBA-në (Doktrina Truman dhe Plani Marshall), që në atë kohe po lëkundej mbështetja nga vetë amerikanët për vijimin e financimit e luftës në Greqi, kundër Ushtrisë Demokratike Greke.

Në fillimet e vitit 1949 të dy mbështetësit e Ushtrisë Kombëtare Greke, SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar për përfundimin sa më të shpejtë të Luftës Civile dhe eliminimin përfundimtar të lëvizjes së armatosur në Greqi, intensifikuan më shumë mbështetjen e tyre ushtarake, si në ndërtimin e aeroporteve, rrugëve, skelave detare etj, në organizimin e fuqizimin e forcës ushtarake me një efektiv prej rreth 300.000 ushtarësh të përbërë nga roja kombëtare, xhandërmëria, njësitë e vetmbrojtjes, njësitë e mbrojtjes kombëtare etj, të cilat shtriheshin kryesisht në qytetet më të rëndësishme greke, përfshi edhe kryeqytetin grek, Athinën. Krahës këtij intensifikimi domethënës, gjenerali Van Fleet, komandanti i Ushtrisë Kombëtare Greke, urdhëroi pastrimin dhe ekstradimin e popullsisë rurale greke nga banesat e tyre, fshatrat, të cilat rezultoni që të ishin zona të veprimtarisë të Ushtrisë Demokratike Greke për të izoluar e shpëputur atë nga popullsia vendase.

Në tërësi kjo luftë jo vetëm u mbështet shumë nga shtypi shqiptar por e rëndësishme për kohën ishte dhe shoqërimi me tubime e me mitingjetë shumta, formë populiste e përdorur që shpesh mbaheshin nga grupimet shoqërore në qytete e rrethe të ndryshme, duke mbështetur popullin grek. Në këto tubime të organizuara edhe nga gratë apo të rinjtë përshëndeteshin nga drejtues politikë por edhe nga pjesëmarrsit duke kuptuar mbështetjen dhe lidhjen vendin tonë me këtë luftë. Gjithsesi, ndonëse u organizuan shumë të tilla në vendin tonë, ato pothuajse nuk patën ndonjë ndikim në arenën ndërkombëtare, përveçse nxisin më shumë monarko-fashistët grekë.

Pas prishjes me Jugosllavinë, studimet gjeostrategjike dhe relacionet e shumta të Fuqive Perëndimore e përcaktuan vendin tonë si "pika më e dobët" e Kampit Socialist, por ndërkohë në kushte politike dhe ekonomike mjaftë të vështira dhe të rrezikshmërisë së pavarësisë së vendit, ajo ishte ndoshta e vetmja që u angazhua më shumë se çdo vend tjetër i Evropës Lindore, duke e ndihmuar ngushtësisht lëvizjen greke e për pasojë, nëpërmjet territorit të

saj lëviznin natën mjetet ushtarake të transportit për furnizimin me armë, municione e ndihma logjistike për këto formacione, të cilët, ngarkoheshin në Portin e Durrësit me ngarkesa të sjella me vaporë apo pas kurimit të ushtarëve të plagosur bëhej kthimi, shoqërimi dhe dërgimi në front i rreth 1500-2000 ushtarëve grekë që kishin kaluar kufirin dhe ndodheshin në territorin shqiptar, në të cilin kishte rezerva të shumta jo vetëm logjistike për edhe armatime të ndryshme, që shpesh u kthyen në akuza kundër vendit tone për ndihma ndaj Ushtrisë Demokratike Greke.

Në faqet e shtypit periodik shqiptar të kësaj periudhe propagandohej edhe ana humane e majtistëve grekë, ku binte në sy artikujt që shoqëroheshin me fakte dhe shembuj të vërtetë, të krimeve dhe padrejtësive që kryeheshin kundër popullsisë greke nga Ushtria monarko-fashiste greke, që nënkuptohej qeveria dhe Ushtria Kombëtare e Athinës. Ajo, jo vetëm gjatë veprimeve të ndryshme luftarake shkatërroi e dogji të mbjellat dhe i ktheu tokat bujqësore në shkretëtira si në Karadievi por njëkohësisht ushtroi terror kundër popullsisë vendase duke i detyruar me dhunë privimin e lirisë. Monarko-fashizmi me terror e me vrasje shpërnguli banorët nga të gjitha zonat ku ishte vendosur pjesa më e madhe dhe më e gjallë e Ushtrisë Demokratike Greke jo për të sulmuar, por për t'u mbrojtur duke i lënë partizanët grekë në vetmi në malet e thata.

Në rrjedhën e veprimtarisë shtrënguese, madje asgjësuese, në kulmin e Luftës Civile, Ushtria Kombëtare Greke me mbështetjen amerikano-britanike, për përkrahjen politike që i jepnin kësaj lufte për ndalimin e rrezikut tëpërhapjes së komunizmit, kreu një sërë operacione çfarosjeje kundër proletariatit dhe elementit revolucionar, pjesës më revolucionare të popullit grek, sindikalistët dhe komunistët, këta të fundit, në përgjithësi, vazhduan të qëndronin në qytete, ku u "vranë rreth 50 mijë persona, 6500 komunistë dhe demokratë u pushkatuan, pasi u dënuan nga gjykatat ushtarake që propagandohej se ishin në duart e amerikanëve, të cilët urdhëruan vdekjen e komunistëve, 50 mijë antifashistë u burgosën, vetëm në Peloponez, 5000 njerëz dhe u internuan e shumë ndërta, u bënë subjekt i torturave të tmerrshme. Subjekte të këtij terrori në Greqinë fqinje, u bënë për shumë artikuj të shtypit tonë periodik të asaj periudhe për dënimet mizore, trajtimet mesjetare ndaj të burgosurve si dhe në gjykimet e panumurta për të cilat u theksua dhe u dënuan deri diku nga e gjithë bota.

Në këtë luftë tërësore civile mbi shina ushtarake të të dy ushtrive të mbështetura nga kahje të ndryshme politike, në verën e vitit 1948, raporti forcave dhe i mjeteve ishte dërrmues në favor të Ushtrisë Kombëtare Greke. Përveç kësaj, i gjithë ky formacion luftarak, tashmë i ritrajnuar dhe përgatitur për luftime malore, me pëlqimin amerikan ai përdori për herë të parë bomba me napalm, të cilat më pas u përdorën më gjerësisht në Luftën e Vietnamit. Vetëm gjatë luftimeve në Gramoz, u përdorën 338 bomba me napalm në territorin e mbrojtur nga Ushtria Demokratike Greke. Për pasojë këto luftime u shoqëruan me shkatërime të mëdha në tokat, ndërtesat dhe njerëzit, të cilat u pasqyruan edhe në shtypin ndërkombëtar.

Përveç kësaj, në shtypin e kohës nëpërmjet artikujve që u botuan u bë një propagandë e madhe rreth vrasjes së Manolis Gleso, kryeredaktorit të gazetës "Rizospastis", një gazetë e majtë në Greqi. Ai ishte përfshirë, që nga vitet e para të pushtimit italian, në grupet komuniste, dhe mbahet si një simbol i komunizmit grek. Po kështu, pushkatimi i 38 sindikalistëve përqasi një lajm të madh dhe u bë objekt propagande i shumë gazetave të shtypit tonë. Ndërkohë pa dritën e botimit edhe letra që i ishte dërguar Stalinit nga të afërmit e një sindikalisti të dënuar, duke kërkuar që të ndërhynte edhe OKB-ja, por ata gjithsesi u çekzektuan.

Propaganda e shtypit shqiptar i asaj periudhe tre vjeçare të çlirimit të vendit ofronte e rrokte njëkohësisht edhe probleme të natyrave të tjera, të ndikuara edhe nga shtypi evropian, siç ishte dështimi i krijimit të qeverisë së re greke si rezultat i mos arritjes së ndarjes së portofoleve të ministrive e shoqëruar me artikuj të tjerë deklarativë që bllokimi i krijimit të qeverisë së re greke bëhej nga amerikanët. Madje, shtypi evropian me artikujt e botuar për luftën civile greke ndikoi për krijimin e opinionëve të ndryshme gjykimi të vetë popujve evropianë, për rrjedhojë opinionet publike të të dy vendeve mbështetëse por edhe financuese, nëpërmjet Planit Marshall, akuzonin qeveritë përkatëse për masakrat masive që po ndodhnin në Greqi. Në thelb, nëpërmjet botimit të këtyre artikujve propagandistikë udhëzohej për bindje ideologjike e politike se vendi ynë jo vetëm kishte nevojë për një unitet politik të brendshëm, por kjo veçanërisht duhet të bëhej kjo gjë edhe me revolucionin popullor grek e fqinjit tonë jugor dhe njëkohësisht vihej në dukje e theksohej se sa luftënxitëse ishte politika e imperializmit amerikan, nëse do të bashkëpunojë me të.

Në thelb, në këto artikuj, kurrë nuk u shkruajt e të pranohej se mbrohej

dhe ndihmohej komunizmi grek madje, do të huazoheshin e botoheshin artikuj nga Radio "Greqia e Lirë", e cila deklaronte se kurrë nuk kishte pasur ndonjë ndihmë nga pala shqiptare, dhe se fitoret u arritën pa ndihmën shqiptare. E ndërkohë, nga Agjencia Telegrafike Shqiptare u deklarua zyrtarisht se ky ishte thjesht shpifje, se çdo element që hynte në vendin tonë neutralizohej dhe dërgohej në zonat e grumbullimit, pas çarmatosjes së tyre.

Në një artikull tjetër, që u botua në shtypin shqiptar, për mohimin e pjesëmarrjes së çamëve në radhët e Ushtrisë Demokratike Greke, konfirmonte zyrtarisht mos pjesëmarrjen e tyre në këto formacione luftarake greke. Megjithatë, dokumentet e deklasifikuara tregojnë të kundërtën. Me gjithë punën e bërë që nga viti 1948 që filloi rekrutimi i çamëve e deri në mars të vitit 1949 u arrit të mobilizoheshin në rreshtat e UDG vetëm 130 veta.

Në këtë kohë, Shqipëria u akuzua se kishte thyer rregullat e Organizatës së KB, duke rrëzuar një aeroplan të KB, për misionin UNSCQB, që po kalonte afër territorit shqiptar. Sidoqoftë, shteti shqiptar nuk e pranoi këtë duke e quajturë dhe këtë shpifje të ashpër ndaj shtetit shqiptar. Artikulli u botua në të gjitha gazetatat që qarkulluan në vend.

Fundi i vitit 1949 përcakttoi fundin e lëvizjes komuniste greke së bashku me Ushtrinë Demokratike e "pushtetin e mori e dhathta konservatore. Greqia mbeti përfundimisht në sferën Perëndimore. Dhe kjo ndodhi për shkak të asaj marrëveshje të përqindjeve mes të mëdhenjëve duke vënë përballë me forcën e armëve, apo me luftën civile faktorët e brendshëm". Në këtë kohë, pothuaj në tërësi, të gjithë artikujt e botuar në shtypin kryesor shqiptar vihet re që kishte ndryshuar tematika e mëparshme por objekt tyre tani ishte veprimtaria politike e ndryshimet ligjore që ndodhnin nën diktatin e Qeverisë Greke siç ishin ato që shkruanin për bashkëpunimin ose lirinë e daljen e shumë bashkëpunëtorëve fashistë nga burgjet e në të njëjtën kohë, u miratuan disa ligje për të çliruar ministrat kuislingë, që kishin bashkëpunuar me pushtuesin gjerman dhe ndërkohë u pushkatuan repertorët dhe gazetarët që ishin pro të majtës greke por pati edhe të tjerë që u torturuan. Në tërësi, të gjitha shkrimet e gazetarëve shqiptarë që u botuan morën edhe iniciu nga disa artikujt deri diku tëshumtë të shtypit të huaj, të cilat e shihnin politikën zbatuese të Athinës si një kërcënim të vërtetë për popujt e Ballkanit.

Kauza e Ushtrisë Demokratike të Greqisë (DSE) pati një solidaritet ndërkombëtar kryesisht nga forcat punëtore-popullore, të lëvizjes komuniste të shteteve perëndimore. Shprehje e këtij solidariteti ishte vizita

e delegacionit të partisë komuniste franceze zonën e Greqisë së Lirë dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Demokratike të Greqisë (DSE) në vitin 1949, në të cilin përfshihej edhe poeti i madh surrealist Pol Eluard.

Kauza e Ushtrisë Demokratike të Greqisë (DSE) pati një solidaritet ndërkombëtar kryesisht nga forcat punëtore-popullore, të lëvizjes komuniste të shteteve perëndimore. Shprehje e këtij solidariteti ishte vizita e delegacionit të partisë komuniste franceze në zonën e Greqisë së Lirë dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Demokratike të Greqisë (DSE) në vitin 1949, në të cilin përfshihej edhe poeti i madh surrealist Pol Eluard.

Në shtypin shqiptar, kjo vizitë, u paraqit si një triumf i komunizmit grek, i cili tani u vizitua edhe nga një parti motër nga perëndimi. Për rrjedhojë nëpërmjet rreshtave të artikujve të shumtë të botuar aludohej se Ushtria Demokratike Greke do të kishte mbështetje akoma më të madhe jo vetëm nga partitë komuniste të vendeve lindore, por tashmë nëpërmjet Partisë Komuniste Franceze do të kishte aleatë edhe organizata të fuqishme ose parti e lëvizje komuniste nga perëndimi. Komunizmi perëndimor, nëpërmjet misionit të delegacionit të partisë komuniste franceze u përpoq që të ndikonte në arritjen e një armëpushimi në këtë luftë të përgjakshme civile dhe pas saj të krijohet një qeveri me pjesëmarrje sa më të gjerë të partive parlamentare, me përjashtim të gjithë partive apo individëve që ishin pro një politike jashtëzakonisht të ashpër.

Kjo ra si një bombë për propagandën shqiptare, e cila dy javë më vonë, në një artikull të dytë, kritikoi ashpër partinë komuniste franceze që ra në revizionizëm. Në fakt, Partia Komuniste Franceze u përpiq që të luante rolin e ndërmjetësit, pa e mbajtur anën e asnjërës nga palët, por gjendja përsëri u përkeqësua akoma më tej me shpartallimin e Ushtrisë Demokratike Greke.

Në gjysmën e parë të vitit 1948, Stalini kishte përforcuar së tepërmi pozitën e tij në disa nga vendet më problematike të Europës Lindore, si në Çekosllavaki, Poloni, Gjermani Lindore etj. pa folur për Shqipërinë, e cila thuhet se e kishte përcaktuar qëndrimin e saj pro komunist menjëherë pas lufte. Në këto kushte, pa e pyetur, BRSS-ja futi në lojë Shqipërinë. Shqipëria ishte i vetmi satelit i Moskës, i cili mbeti besnik, në naivitetin e tij, por që ishte i rrethuar nga kundërshtarët e Bashkimit Sovjetik. Në zbatim të synimeve të tyre strategjike ajo synonte që të vendoste kontrollin mbi ngushticën e Otrantos e përmes asaj të Mesdheut. Pas prishjes së marrëdhënieve

me Jugosllavinë, BRSS-ja fitonte epërsi të dukshme e të munguar në pëllgun mesdhetar.

Ndërkohë propaganda e shtypit shqiptar për politikën e jashtme për problemet korente greke, orjentohej po përsëri nga Bashkimi Sovjetik, i cili ishte idhulli dhe tabuja e tij, madje dhe kryertikujt kishin tematika apo referime nga shtypi i saj. Për rrjedhojë, ky orjentim politik ndikonte dukshëm padyshim edhe në shtypin e shkruar shqiptar, i cili zgjidhjet apo mendimet direktiva ishin tematika të artikujve të botuara në perioidikët shqiptar. Për rrjedhojë sipas direktivës ruse për zgjidhjen më të mirë për Greqinë ishte puna "legale" dhe parlamentarizmi me zgjidhje të paqes, pra zgjedhje të lira në Greqi dhe kështu revolucioni do të fitohej me rrugën e parlamentarizmit dhe votime me zgjedhje të lira. Një veprim i tillë u krye në Hollandë, Poloni dhe Çekosllavaki, gjatë vitit 1948, ku nën idenë e "zgjedhjeve të lira" u imponua komunizmi në këto vende. Një gjendje e tillë në parim do të thoshte të njëjtin fat edhe për Greqinë. E njëjta gjë ndodhi edhe me ne, kur sipas propagandës shqiptare, Bashkimi Sovjetik ishte mbrojtësi ynë nga Greqia, sidomos gjatë sulmeve në kufi në gusht të vitit 1949. Madje, mori guxim në një artikull sovjetik për të deklaruar se SHBA ishte prapa Greqisë, në përpjekjet e saj për të pushtuar Shqipërinë.

Një hapësirë të madhe të propagandës të përhapur përmes shtypit për ngjarjet në Greqi, u mbulua nga artikujt e shumtë që sulmonin SHBA-në, si shkaktari i asaj situatë. Një akuzë e madhe nëpërmjet shtypit iu bë Presidentit Truman, i cili që nga viti 1948 me mbështetjen e Kongresit Amerikan financoi mbajtjen ushtrisë monarko-fashiste me fonde të larta monetare. Po kështu, Amerika shihej si udhëheqësi kryesor që qeveriste vendin si dhe detyroi mbretin Pavli të Glitsburg që të kërkonte ndihmë nga amerikanët. Ndërkohë gjatë luftës civile, humbjet ishin të pranishme, por ndihma amerikane në Greqinë monarkiste ishte shumë më e madhe, mbi 300 milion dollarë, të gjitha këto në kuadrin e Planit Marshall, që falë kësaj ndihme, mundi të përballonte këtë krizë në pjesën më të madhe të Greqisë.

Në kohët e sotme, kur po thuhet të gjitha dokumentet janë deklasifikuar dhe studiuesit janë duke u konsultuar me to po hidhet dritë dhe njohjen e ngjarjeve si dhe personazhet që kanë ndikuar në zgjidhjet e kësaj apo asaj forme në periudha të ndryshme të historisë. Për rrjedhojë në këtë kohë mund të konsultohemi me dokumentet dhe të gjejmë një lidhje midis SHBA, Greqisë dhe Shqipërisë. Por

cila ishte?

Presidenti Truman, në raportin vjetor përpara Kongresit Amerikan, për tematikën e ngjarjeve e kësaj periudhe në Greqinë monarkiste, pranoi për vonesën e përfundimit të luftës civile, që mendohej se do të përfundonte në fund të vitit 1948, duke argumentuar se një pjesë e luftëtarëve guerilas, rreth 8 mijë andartë, gati një e treta e asaj që gjendeshin në Bullgari pas operacioneve në Gramoz u shpërndanë dhe u larguan për në Shqipëri. Kjo gjë, shtyu për më tej kohën e likuidimit të tyre. Kjo ishte një arsye më shumë që SHBA-ja lejoi përdorimin e lëndës djegëse, napalmit nga Ushtria Kombëtare Greke në zonën e Gramozit, pasoja e përdorimit të tyre, ndihen akoma edhe në ditët e sotme atje. Kjo ishte më shumë një përpjekje për të ndaluar forcat e Ushtrisë Demokratike Greke që të mos kalonin kufirin shqiptar, në vend se të hakmerrej ndaj shqiptarëve.

Faktet dhe dokumentet treguan se sa SHBA mbështesin Shqipërinë. SHBA kishte thirrur gjithnjë për një tërheqje të shqiptarëve nga ndihma ndaj komunizmit grek. Në këmbim, ajo kishte premtuar integritetin e Shqipërisë si një anëtar i plotë i KB. Sidoqoftë, kjo nuk ndodhi kurrë. Një hap i madh prapa për vendin tonë dhe një humbje e madhe për shqiptarët, të cilët edhe pa këtë luftë, ishin në një varfëri ekstreme.

Asnjë prej tyre nuk e mbështeti Greqinë, kur kërkoi aneksimin e Vorio Epir. Ajo kishte deklaruar se ne nuk duam të shtojmë vuajtje të shqiptarët, më shumë sesa ato që po shkakton regjimi komunist, ne me sa duket nuk do ta njihim këtë regjim.

Megjithë faktet e dhëna, shtypi dhe ato të dokumentuara, ne mund të kuptojmë diçka shumë të rëndësishme: Shteti Komunist Shqiptar, u distancua shumë nga realiteti kombëtar, shumë më tepër sesa grupimet politike në Greqi. Kjo e bëri Shqipërinë të verbër me problemet e saj të brendshme dhe kështu të bashkohej me ideologjinë komuniste, duke sfiduar pothuajse atë Stalinist. Kjo politikë shkatërroi vendin dhe ishte hapi i parë drejt izolimit të vendit, jo vetëm nga Evropa, por nga i gjithë Ballkani. Shtypi shqiptar, arma më e rëndësishme dhe e rrezikshme, nuk kishte si synim jashtë, por brenda vendit. Shtypi i një vendi të vogël nuk pati një ndikim të madh jashtë, por ai i brendshëm ishte i madh. Shtypi na tregon se që nga kjo luftë, dhe katër dekadat pasuese, vendi ynë, nuk kishte një gardh hekuri që na ndante nga Perëndimi, por një bunker mbi kokën e tij, duke e izoluar atë nga Perëndimi, si dhe nga Lindja.

Në kuadër të 78-vjetorit të krijimit

Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së dhe roli i tij në luftën e II Botërore



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Qendër organizative, politike e operative e të gjithë fuqive të armatosura antifashiste

Rritja e forcës luftarake e formacioneve ushtarake vullnetare partizane, synimi për të shndërruar LANÇSH në një kryengritje të armatosur, si dhe objektivat për të kaluar në veprime operativo-strategjike, në korrik 1943 bënë të domosdoshme krijimin e një organi të specializuar për drejtim ushtarak. Për këtë qëllim Këshilli i Përgjithshëm Antifashist NÇ (KANÇSH) më 10 korrik 1943 në Labinot të Elbasanit formoi Shtabin e Përgjithshëm të UNÇSH-së, që përbën një nga ngjarjet më të madha në Luftën Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Ky shtab nuk kishte formë dhe përmasa klasike të shtabit të një ushtrie moderne, por kishte origjinalitetin dhe veçoritë e veta organizative. Në vendimin për krijimin e tij, KANÇSH e përcaktonte Shtabin e Përgjithshëm "... si një qendër organizative, politike e operative e të gjithë fuqive të armatosura antifashiste". Për qëndresën e armatosur popullore kundër pushtuesit, gati çdo gjë, veç vullnetit të pashtershëm e të pa epur të popullit për liri e përparim, filloi gati nga embrionet. Kjo më e dukshme ishte në pamjen ushtarake.

Në rrethana të tilla, djem dhe vajza



të popullit me veprime konkrete, u futën në radhët e shtresave të ndryshme të popullsisë për ta bindur, bashkuar e organizuar për luftë të armatosur për çlirimin e vendit nga pushtuesi. Përfaqësues të rrymave të ndryshme nacionaliste dhe të Partisë Komuniste të Shqipërisë (përkatësisht 12 e 6 veta), u mbledhën më 16 shtator 1942 në Pezë, duke krijuar Frontin Nacionalçlirimtar. Ky i fundit, si organ më të lartë politiko-ushtarak në shkallë vendi, krijoi Këshillin e Përgjithshëm NÇ. Fryma e detyrat që shtroi Konferenca e Pezës dhe shtrirja e tyre në masat e gjëra popullore, bënë që deri nga mesi i vitit 1943, qëndresa e armatosur popullore të merrte shtrirje të gjerë. Në radhët e formacioneve partizane kishte rreth 10.000 partizanë të përfshirë në 20 batalione e mbi 30 çeta partizane, krahas rreth 20.000 të tjerëve në radhët e forcave vullnetare e territoriale. Ky zhvillim i organizimit ushtarak dhe i veprimeve luftarake kishte bërë që anë e kënd Shqipërisë të krijoheshin "Zona të Lira" si në Pezë, Kurvelesh, Mesaplik, Skrapar,

Gorë-Opar, Çermenikë, Martanesh, Dibër, Tropojë, Mbishkodër etj., duke mbuluar gati 50% të territorit të vendit. Në këtë mënyrë ishin krijuar kushtet optimale të domosdoshme për të kaluar në një shkallë më të lartë të organizimit ushtarak por edhe të objektivave të luftës çlirimtare. Por, jo vetëm zhvillimet e brendshme por edhe ato të jashtme, në kuadrin e Koalicionit të Madh Antifashist, kishin shënuar kthesën e madhe në fatet e Luftës së Dytë Botërore. Kishin përfunduar me asgjësimin e grupimit gjerman betejat e El Alamanit dhe të Stalingradit, si betejat fillestare të kthesës së madhe, kishte filluar operacioni desant detar në Sicili dhe në Frontin e Lindjes përgatitej beteja e Kurskut që do të shënonte kthesën përfundimtare në fatet e gjithë luftës. Tashmë vështrimi i aleatëve të mëdhenj po drejtohej më pranë Ballkanit dhe Europës Qendrore.

Organ i specializuar ushtarak

Në këto rrethana, në kuadrin e brendshëm, krejt natyrshëm dilte

nevoja e krijimit të një organi të specializuar ushtarak për drejtimin operativ-strategjik të luftës brenda vendit, por edhe për koordinimin e veprimeve me forcat aleate. Ky organ ishte Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së. Ai u krijua me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Si vetë Këshilli që kishte karakter pluralist, edhe Shtabi i Përgjithshëm, për nga përbërja, kishte po karakter të tillë. Krahas përfaqësuesve të PKSH-së, si formacioni kryesor politik i luftës (Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Ramadan Çitaku, Mustafa Gjinishi, Nako Spiru, Dali Ndreu, Bedri Spahiu) në përbërje të tij u futën edhe nacionalistë që pranonin platformën e Frontit NÇ për luftën (Myslim Peza, Abaz Kupi, Haxhi Lleshi, Baba Faja, Spiro Moisiu). Shtabi i Përgjithshëm, në mbledhjen e tij të parë, sikurse shprehet në procesverbalin përkatës, "... zgjodhi unanimisht si komandant të shtabit z. Spiro Moisiu...", dhe si komisar z. Enver Hoxha". Ai përcaktoi edhe strukturën organizative të tij të përbërë nga: shtabi operativ, komisar-iati politik, komisar-iati ekonomik, sektori i brendshëm, seksioni i ndërlidhjes dhe disa specialistë. Detyrat e Shtabit të Përgjithshëm përmbledheshin në tre drejtime kryesore: organizimi i UNÇ-së, realizimi i udhëheqjes operative e strategjike të luftës dhe përpunimi i taktikës së luftës popullore. Në fokusin e këtyre detyrave, Shtabi i Përgjithshëm, nëpërmjet urdhreve, udhëzimeve, rregulloreve, të deleguarve pranë komandave vartëse etj., përcaktoi kriteret e masat konkrete të organizimit të formacioneve të veçanta dhe të ushtrisë në tërësi, duke kaluar nga çetat e batalionet në brigada e më pas, me rritjen cilësore të luftës dhe të organizimit ushtarak, krijimin e divizioneve dhe të korparmatave si njësi operativ-strategjike; përcaktoi dhe përsosi organizimin, pajisjen dhe funksionimin e disa llojeve të shërbimeve, si atë informative, të ndërlidhjes, të xhenios, të prapavijës, artilerisë etj.; pajisjen me armatim, municion, furnizimin me ushqim e veshmbathje të formacioneve partizane; organizimin e popullit të armatosur në formacionet vullnetare territoriale si forca rezervë në ndihmë të UNÇ-së; organizimin e drejtimin e pushtetit ushtarak të vendit (komandat e qarqeve, komandat e vendit, rojat partizane e ato vullnetare). Për secilën nga këto drejtime e detyra, Shtabi i Përgjithshëm përpunoi e shpërndau urdhra e udhëzime konkrete, duke siguruar edhe zbatimin e tyre.

Përpunimi i teorisë dhe veprimeve luftarake

Një drejtim tjetër i rëndësishëm i punës së Shtabit ishte edhe përpunimi i teorisë dhe i formave konkrete të

veprimeve luftarake të formacioneve vartëse në veçanti dhe të ushtrisë në tërësi. Mbështetur në parimet e luftës çlirimtare dhe përvojën e gjallë luftarake shumëshekullore të popullit tonë, në vartësi të etapave të zhvillimit të luftës dhe të vet ushtrisë, Shtabi përcaktoi: rregullat e kriteret e përqendrimit të forcave në kohën e vendin e duhur, përcaktimin e zgjedhjen e drejtimin të goditjes kryesore, të bashkëveprimit ndërmjet vet formacioneve partizane dhe të këtyre



të fundit me formacionet vullnetare territoriale që shtriheshin në të gjithë vendin; rregullat e përballimit të operacioneve mësimëse të armikut me forca superiore. Në themel të taktikës partizane dhe të asaj me front të rregullt (kur u përdor) si dhe të përgatitjes luftarake, u vunë tiparet kryesore të taktikës partizane si shpejtësia, vrulli, shfrytëzimi i terrenit, i errësirës e motit, manovra, guximi, ruajtja e fshehtësisë së idesë dhe të forcave. Si metodë kryesore, për vetë kushtet e luftës dhe të ushtrisë më të vogël në numër, u vu metoda e asgjësimit të armikut pjesë-pjesë. Gati një vit më pas nga koha e krijimit të SHP-së, në maj 1944, situata politiko-ushtarake në vend kishte ndryshuar së tepërmi. Këtë lindi nevoja për përcaktimin e objektivave të reja e përfundimtare strategjike të luftës për çlirimin e vendit dhe kalimin e ushtrisë në një shkallë më të lartë organizimi, të aftë të përballojë detyrat e reja strategjike. Kjo u materializua me vendimet e Kongresit të Parë ANÇ, që u mbajt në Përmet më 24 maj 1944. U vendos që të kalohej në mësimje të përgjithshme strategjike për çlirimin e vendit, kalimin e ushtrisë nga ushtri vullnetare partizane në ushtri të rregullt (edhe në pamjen organizative, krahas brigadave do të krijoheshin edhe 8 divizione dhe 3 korparmata, si njësi operativ-strategjike me rreth 70.000 partizanë); vendosjen e gradave në ushtri; krijimi i Komandës

së Përgjithshme si organ i njësuar ushtarak.

Komanda dhe Shtabi i Përgjithshëm drejtuan me aftësi UNÇ-në në përmbushjen e misionit të saj përfundimtar strategjik për çlirimin e vendit. Madje, një pjesë e formacioneve partizane luftuan edhe për çlirimin e pjesës më të madhe të trojeve shqiptare jashtë kufijve të shtetit amë. Duke plotësuar me dinjitet angazhimin e vet në kuadrin e Koalicionit të Madh Antifashist Botëror, Komanda

e Përgjithshme, Shtabi i Përgjithshëm dhe ushtria shqiptare ndoqën pushtuesit gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tij, që u tërhoqën me të, deri në Vishegrad (Bosnjën Jugore). Populli shqiptar, me ushtrinë e tij të udhëhequr ushtarakisht me aftësi profesionale nga Shtabi i Përgjithshëm, e radhiti më dinjitet veten në radhën e fitimtarëve duke bërë pluhur e hi edhe synimet grabitqare të shoveneve fqinjë që shpresonin e punonin që Shqipëria të radhitej me të mundurit dhe vendi të kthehej në plaçkë tregu për lakmitë shoviniste. Pikërisht kjo përbën edhe fitoren e meritën më të madhe të popullit tonë në këtë luftë dhe justifikon gjithë sakrificat duke e radhitur atë në radhët e para të popujve që kontribuan më tepër në fitoren mbi fashizmin dhe nazizmin. Ndaj edhe brezi që bëri luftën meriton nderimin e brezave më të rinj.

Ushtria pas çlirimit të vendit, në kushtet e reja politiko-shoqërore, u reduktua në sasinë numerike, u modernizua me të gjitha llojet e armëve dhe të forcave si dhe u pajis me armatim modern të kohës. Forcat e Armatosura nuk njohën asnjë ndërprerje, duke realizuar me sukses misionin e vet në mbrojtje të Atdheut. Në kushtet e transformimeve demokratike në Shqipëri, Forcat e Armatosura sërish u transformuan në parametra të reja që burojnë nga kushtet e reja politike e shoqërore, në shërbim të lirisë dhe të paqes.

Forcat e Armatosura angazhim maksimal në shuarjen e zjarreve



Strukturat e Forcave të Armatosura janë angazhuar maksimalisht në disa zona të vendit për shuarjen e zjarreve. Që prej datës 23 korrik, efektivë të Forcës Tokësore dhe të Forcës Detare janë angazhuar për shuarjen e zjarreve në zonën e Karaburunit, malin e Tomorit, Cakranit në Fier si dhe në Laç, duke sfiduar terrenin dhe temperaturat ekstreme të këtyre ditëve. Në këtë operacion janë përfshirë 100 trupa të pajisura me bazë material të dedikuar për shuarje zjarresh. Ky operacion vazhdon pandërprerë ditën dhe natën, duke freskuar trupat e angazhuara në operacion.